



Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Po punohet për ringjalljen e industrisë së prodhimit të armëve në Shqipëri



4 mars, gati Baza Ajrore e Kuçovës

Baza Ajrore Taktike e NATO-s në Kuçovë do të nisë aktivitetin e saj së shpejti. Ajo do të luajë një rol kyç në mbështetjen e operacioneve dhe stërvitjeve të NATO-s, duke shërbyer edhe si një qendër për aktivitetet e Forcave Ajrore, me infrastrukturë të avancuar për avionët luftarakë dhe ata të transportit të Aleancës.

Baza Ajrore Taktike e NATO-s në Kuçovë do të inaugurohet më 4 mars. Tashmë ajo është shndërruar në një gjurmë të rëndësishme të prezencës së NATO-s dhe do të jetë në shërbim të stërvitjeve dhe operacioneve të ndryshme të Aleancës.

Baza Ajrore e NATO-s në Kuçovë është e vetmja bazë taktike për operacionet kombëtare dhe operacionet me rëndësi strategjike të NATO-s në Ballkanin Perëndimor.

Investimi në këtë bazë arrin vlerën e rreth 45,8 milionë eurove dhe konsiston në ndërtimin e depove të armatimit, ato të karburantit, stacioneve të armatimit, parkingut të avionëve, stacionit kundër avarive dhe zjarreve, rindërtimin e pistës dhe kullës së kontrollit.

Rindërtimi i bazës ajrore të Kuçovës nisi në janar të vitit 2022. Ish-baza e epokës komuniste e ndërtuar me punë vullnetare, në vitin 1952, shtatë dekada më pas do t'i shërbejë operacioneve të Aleancës Atlantike.

Vendimi i Aleancës së Atlantikut të Veriut për të ndërtuar në Shqipëri bazën e parë ajrore u njoftua në verë të 2018-s.

Për Ministrinë e Mbrojtjes, hapja e bazës



ajrore në Kuçovë lidhet ngushtësisht me dy elementë: me përfundimin e të gjithë investimit të NATO-s, si dhe me realizimin e një sërë projektsh që janë pjesë e detyrimeve të palës shqiptare si pjesë integrale e këtij investimi.

Ngritja e kësaj baze, 15 vite pasi Shqipëria iu

bashkua NATO-s, shkon përtej interesit të vetëm një shteti.

Si një shtet anëtar i Aleancës më të madhe Politiko-Ushtarake, shteti shqiptar dhe FARSH, me këtë investim që po realizohet, do t'i ofrojë NATO-s një bazë ajrore me infrastrukturë dhe

kapacitete moderne si dhe standarde bashkëkohore, të cilat do të bëjnë të mundur dislokimin e mjeteve ajrore të Aleancës apo edhe mjeteve tona ajrore, në situata të ndryshme qoftë për operacione stërvitore apo edhe për detyra të tjera në interes të Aleancës.

Forcat Speciale / ROS, përfunduan me sukses stërvitjen trajnuese "JCET 24-1"

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji mori pjesë në stërvitjen trajnuese "JCET 24-1" të Forcave Speciale të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS).

Në këtë ceremoni, e cila u zhvillua në Regjimentin e Operacioneve Speciale, ishin të pranishëm gjithashtu i ngarkuari me punë në Ambasadën e SHBA-ve, në Tiranë, z. David Wisner, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, përfaqësues të ODC, si dhe të ftuar të tjerë.

Të pranishmit në këtë ceremoni, panë nga afër demonstrimet e kombinuara nën drejtimin e instruktorëve amerikanë. Kjo është një stërvitje ku përfshihen trajnime efektive tona speciale nga instruktorë të forcave speciale amerikane. Gjatë trajnimit efektivët realizuan tema si trajnim mbi udhëheqjen dhe planifikimin, teknikat e qitjes dhe shpimit, operacionet luftarake në mjediset urbane, zhvillimin dhe drejtimin e operacioneve speciale, taktikat e njësive të vogla si dhe standardizimin e taktikave dhe procedurave.

Kjo stërvitje i shërbeu rritjes së aftësive profesionale të operatorëve specialë, rritjes së ndërveprueshmërisë, punës në grup dhe besimit reciprok gjatë kryerjes së misioneve luftarake.



Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Po punohet për ringjalljen e industrisë së prodhimit të armëve në Shqipëri

Takimi i Nivelit të Lartë “Ukrainë – Europa Juglindore” u mbajt në Tiranë, me pjesëmarrjen e Presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelensky.

Samiti ishte një shprehje e mbështetjes për Ukrainën, që prej dy vitesh po përballet me agresionin e paprovokuar.

Kjo është vizita e parë e Zelenskyt në Shqipëri, ndërkohë që kryeministri i Shqipërisë z. Edi Rama udhëtoi drejt Kievit në qershor të vitit 2022, disa muaj pas nisjes së luftës në Ukrainë, ku vizitoi zonat e bombarduara të Borodyanka dhe Irpin.

Samiti u zhvillua si një takim solidariteti e angazhimi të mëtejshëm të demokracive të vendeve kundër agresionit rus, ku u diskutuan rrugët e bashkëpunimit në ofrimin e mbështetjes për Ukrainën dhe në kontributin e sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe Evropë.

I pyetur se çfarë fiton Shqipëria në këtë mes, kryeministri Rama tha se: “Mbështetja po bëhet edhe për vendin tonë dhe për mënyrën si e shohim të ardhmen. Ne e kemi mbështetur Ukrainën edhe me paketa mbështetjeje që nuk janë hua dhe nuk janë pjesë e ndonjë biznesi. Kurrë nuk i kemi kërkuar Ukrainës të paguajnë mbrapsht, ndonjë gjë nga ato që kanë marrë prej nesh, modeste. Por jemi të vetëdijshëm se për atë front lufte kjo është diçka shumë e vogël. Po e bëjmë për veten tonë. Ky nuk është një kërcënim ekzistencial vetëm për Ukrainën. Ky është kërcënim ndaj gjithçkaje që ne mendojmë se duhet të jetë e ardhmja jonë. Nëse duam një të ardhme në BE, nuk duam ta shohim BE-në të shpërbëhet.

Ka pasur shumë sanksione kundër Rusisë, por ne e dimë që varësia nga gazi rus, nga nafta ruse, nuk është kaq e thjeshtë kështu që rritja e çmimeve në vendet më të pasura janë pjesë e planit për të bërë publikun të nisë e të thotë “nuk mund të vazhdojmë të mbështesim Ukrainën”, - u shpreh kryeministri Rama.

Nga ana e tij presidenti Zelenski falënderoi Shqipërinë për ndihmën dhe tha se dy vendet duhet të mbështesin njëri-tjetrin në rrugën drejt integritetit europian. “Dëshiroj t’ju falënderoj juve Edi, popullin tuaj, të gjithë shqiptarët për mbështetjen e sinqertë që ju na keni dhënë ne, popullit tonë dhe mbështetjen që i jepni drejtësisë në Europë. Ju falënderojmë për të gjitha paketat që keni mbështetur. Na duhet më shumë besim të çfarë mund të bëjmë ne. Duhet që ju të keni besim te ne. Ne mbështesim edhe integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, por duhet që edhe ju të na mbështesni ne. Faleminderit për vullnetin tuaj të qartë. Ukraina si edhe i gjithë rajoni i Europës Juglindore, duhet të bashkëpunojmë, të ecim përpara, të na mbështesni edhe në formulën tonë të paqes, planin me një pikë. Lufta është filluar nga një person i vetëm, por punën për paqe do ta bëjmë të gjithë së bashku”, - përfundoi Zelensky.

Për mediat ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, pasi shprehu përkrahjen e institucionit që ai drejton ndaj popullit ukrainas, u shpreh se do të ringrihen uzinat e dikurshme të prodhimit të armëve, se po punohet për ringjalljen e kësaj industrie në vendin tonë.

Sipas tij, nga kjo industri Shqipëria do të ketë përfitime ekonomike, por gjithashtu do

forcojë dhe kapacitetet e saj mbrojtëse. “Nuk e kishim menduar se do vinte koha e një konflikti konvencional. Dy vite më parë Rusia tronditi gjithë situatën gjeopolitike në botë. Në aspektin ekonomik është një industri që siguron të ardhura, por edhe në forcimin e kapaciteteve mbrojtëse sidomos në këto kohë ku paqja dhe stabiliteti janë në kërcënim”. Ministri i Mbrojtjes shtoi gjithashtu se së shpejti do të kryhet një studim fizibiliteti,

ku do të shihen fabrikat e prodhimit të armëve në Gramsh dhe Poliçan, e më pas do të kërkohen investime për të vënë në funksion fabrikat e armatimeve. “Ka disa aktivitete minore prodhimi, edhe ajo e Gramshit dhe Poliçanit është pasive. Ne duam të futemi në industri, dhe po kërkojmë investime. Kemi bërë hapa serioze me MSPA për të hartuar një studim fizibiliteti. Pjesa e madhe e makinerive nuk punon më, gjithashtu gjendja e

industrisë ushtarake në vendin tonë dihet dhe se po synohet të ringrihet dhe rigjenerohet në bazë të standardeve të NATO-s”.

Ministri i Mbrojtjes deklaroi se kompanitë e armatimeve nuk do të bëhen vetëm për të furnizuar Ukrainën por do të jetë një industri më e gjerë. Në fund ai iu bëri një thirrje investorëve përfshirë dhe atyre shqiptarë, që të hedhin sytë nga biznesi i sigurisë dhe mbrojtjes.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji, i shoqëruar nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, mori pjesë në Ditën e Vizitorëve të Shquar (DVD) të stërvitjes “Mbrojtja e Qëndrueshme - Voskopoja '24”.

Stërvitja “Mbrojtja e Qëndrueshme - Voskopoja - 24”, u zhvillua në rajonin e Voskopojës, në Korçë, pati si qëllim testimin e aftësive operacionale të nënrepartit të gatishmërisë së Grup-Batalionit të Bashkimit Evropian për dislokim dhe rritjen e aftësive operacionale për kryerjen e detyrave taktike në një operacion luftarak, dhe jo vetëm, të kompanisë së deklaruar NRF për vitin 2024, si dhe të shtabeve të regjimentit dhe batalioneve për të planëzuar dhe për të ndjekur dinamikat operacionale të nënreparteve të manovrës dhe atyre mbështetëse.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, në fjalën e tij, pasi falënderoi efektivat e Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar u shpreh ndër të tjera: “Forcat tona të Armatosura kanë hyrë tashmë në një periudhë intensive aktiviteteve stërvitore brenda dhe jashtë vendit, ndër të cilat do të theksoja angazhimin në stërvitjet ‘Brilliant Jump 24’ dhe ‘Crystal Arrow’ në kuadër të ‘Steadfast Defender’ 24”, e cila është stërvitja më të madhe që ka zhvilluar Aleanca nga përfundimi i Luftës së Ftohtë. Duke qenë pjesë e Aleancës, është domosdoshmëri që në operacionet, misionet dhe stërvitjet e drejtuara prej saj të jemi të ndërveprueshëm me forcat e tjera pjesëmarrëse. Për këtë i shërbeu dhe kjo stërvitje ku ju, testuat efektivitetin e planëzimeve, kapaciteteve operacionale të formacioneve tuaja luftarake dhe nivelin real të gatishmërisë...”.

Duke u ndalur në konceptin e ri që aleanca po vë në jetë, gjeneralmajor Kingji vuri theksin në planëzimin dhe realizimin e stërvitjeve të drejtuara nga Regjimenti i Këmbësorisë së Jugut, duke i kushtuar vëmendje të veçantë reflektimit të këtyre koncepteve të reja për shkurajimin dhe mbrojtjen dhe kriteret për zbatueshmërinë e saj.

“Aleanca në të cilën bëjmë pjesë është në proces të vazhdueshëm transformimi, për t’u

Gjeneralmajor Arben Kingji merr pjesë në stërvitjen “Mbrojtja e Qëndrueshme - Voskopoja '24”



bërë ballë më mirë ndryshimeve në mjedisin e sigurisë në zonën Euroatlantike dhe kërcënimeve të identifikuara në konceptin strategjik të saj. Element thelbësor në këtë koncept të ri të shkurajimit

dhe mbrojtjes është vënia në funksion e modelit të ri të forcës së NATO-s dhe planeve rajonale. Në këtë drejtim, në planëzimin dhe realizimin e stërvitjeve të drejtuara nga regjimenti juaj, vë-

mendje e veçantë t’i kushtohet reflektimit të këtyre koncepteve të reja për shkurajimin dhe mbrojtjen, dhe kriteret për zbatueshmërinë e saj”, - u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Kingji.

SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji priti ministrin e Industrive Strategjike të Ukrainës z. Oleksandr Kamyshin

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji priti ministrin e Industrive Strategjike të Ukrainës z. Oleksandr Kamyshin. Gjatë takimit u diskutua mbi mbështetjen e plotë politike dhe ushtarake të Shqipërisë ndaj Ukrainës, si dhe rolin aktiv në arenën ndërkombëtare për dënimin e sulmit rus, si një cenim i paprecedentë ndaj sigurisë dhe paqes në botë. Që nga fillimi i luftës dy vite më parë, dy vendet tona kanë parë nivelin më të lartë të bashkëpunimit, i dëshmuar sot me mbajtjen e samitit për Ukrainën.





Zhvillohet takimi dypalësh ndërmjet Forcës Detare shqiptare dhe Forcës Detare greke

Në Komandën e Forcës Detare/Rojës Bregdetare, u zhvillua takimi dypalësh (staff talks) ndërmjet Forcës Detare shqiptare dhe Forcës Detare greke.

Delegacioni i Forcës Detare greke, i kryesuar nga kapiten i rangut I Spyridon Pollatis, drejtor i Planifikimit dhe Politikave të Mbrojtjes, u prit në takim nga komandanti i FD/RB, kundëradmiral Adnand Agastra.

Në takim u diskutuan çështje që lidhen me fushat e bashkëpunimit dhe më konkretisht, pjesëmarrja në stërvitjet e ofruara nga pala greke në kuadër të NATO-s, vijimi i stërvitjeve dypalëshe dhe ato rajonale në kuadër të nismës "Adrion", ku marrin pjesë të dy shtetet respektivë, si dhe pjesëmarrja e personelit shqiptar në kurset dhe trajnimet që ofrohen nga pala greke në Qendrën e NATO-s për Trajnimin e Operacioneve të Ndjekjes në Det (NMIOTC) në Kretë, Greqi.

Në përfundim u ra dakord që takimet dypalëshe në nivel shtabi (staff talks) të zhvillohen çdo dy vjet.



SFAB përfundon trajnimin e efektivëve të FT, si Vrojtues të Përparuar dhe Drejtim Zjarri të mortajave

Në mjediset e Forcës Tokësore u krye ceremonia e certifikimit të efektivit të dy reparteve, atij të Batalionit të Artilerisë në Regjimentin e Mbështetjes me Luftim dhe Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (BKL), të cilët morën pjesë në trajnimin si vrojtues të përparuar dhe drejtimin e zjarrit të mortajave.

Në këtë ceremoni ishte i pranishëm dhe komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, i cili në fjalën e tij përshëndetëse, pasi falënderoi ekipin amerikan të SFAB për ndikimin e drejtpërdrejtë të punës së tyre në arritjen e objektivave të BKL/ GBKL, theksoi se: "Forca Tokësore në kuadër të përmbushjes së detyrimeve kombëtare por dhe Paketës së Objektivave të Kapaciteteve të NATO-s, është në një fazë të rëndësishme të modernizimit me armatim, sisteme e pajisje ushtarake, pjesë e së cilës është dhe modernizimi i kapaciteteve të mbështetjes me zjarr të trupave të luftimit dhe rritjes së fuqisë luftarake të zjarrit direkt dhe indirekt, nëpërmjet kompletimit me sisteme të mortajave 120mm të montuara mbi mjete dhe sistemeve të artilerisë vetëlëvizëse 105 dhe 155mm. Për këtë duhet që trajnimet e ardhshme të përfshijnë një pjesëmarrje më të lartë të personelit duke synuar certifikimin e personelit potencial si instruktor, për sigurimin e vazhdimësisë së trajnimit në strukturat e FT".

Ky trajnim u krye nga ekipi amerikan i SFAB (Security Force Assistance Brigades - Brigada e Ndihmës së Forcave të Sigurisë) të Ushtrisë



Amerikane të atashuar pranë BKL, i drejtuar nga kapiten Kevin Kraweski, zgjati një muaj, ku morën pjesë 14 efektivë të FT-së.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte aftësimi i efektivëve në kryerjen e detyrës së vrojtuesit të përparuar dhe në drejtimin, korrigjimin dhe thirrjen e zjarrit. Kjo stërvitje e planëzuar në tre faza, atë

të planëzimit, trajnimit dhe testimit përfundimtar, u fokusua në trajnimin e efektivëve në drejtim të komunikimit, ndërlidhjes, ndërtimin e skicave të terrenit, kërkesës së mbështetjes me zjarr dhe korrigjimin e tij.

Përveç standardizimit të veprimeve sipas procedurave të NATO-s për VP (vrojtues të për-

paruar) dhe DZ (drejtim zjarri) nga ekipi amerikan iu kushtua rëndësi certifikimit të personelit në rolin e instruktorit për drejtimin e zjarrit të vrojtuesin e përparuar, në mënyrë që të ketë vazhdimësi trajnimi i reparteve në Forcën Tokësore.

Në ceremoni u shpërndanë certifikata dhe u mbyll me një foto të përbashkët.





**GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ,
EKSPERT PËR SK, RAJONIN DHE NATO-N,
ZV/PRESIDENT I KËSHILLIT TË ATLANTIKUT**

Sic është gjerësisht e njohur, dy ditët në vijim (28 -29 shkurt) në Tiranë do të zhvillohet “Samiti për Ukrainën”, ku do të marrin pjesë Presidenti Zelensky si dhe zyrtarët më të lartë të Brukselit, vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe të Europës Juglindore. Si çdo ngjarje madhore që mbart interesa kombëtare, sigurisht po e ndjek me vëmendje dhe përgjegjësi shtesë. Ndërsa jo vetëm në këtë rast, kam zgjedhur të mos jap “opinione të nxituara” ndaj interesimit të mediave kryesore brenda dhe jashtë vendit, pasi me vetëdije kam refuzuar: “për të mos u bërë as pjesë dhe as palë e shpërdorimit politik dhe tallavasë bolshevike që fatkeqësisht i shoqëron edhe këto ngjarje madhore”.

Gjithsesi, për shkak të peshës gjeopolitike jo vetëm për Tiranën Zyrtare që mbart kjo ngjarje madhore, në vijim po adresoj disa këndvështrime dhe pikëpyetje paraprake:

Në krye të herës, dëshiroj ta nënvizoj fort, se organizimin e këtij Samiti në Tiranë e çmoj si gjetje të mençur, ambicie/kurajë serioze si dhe sfidë që i bën nder Shqipërisë.

Kjo, jo vetëm për distancën me Ukrainën (2214km) dhe pozicionin gjeografik por edhe për peshën gjeopolitike që gjithsesi tejkalon mundësitë që mund të mbajnë shpatullat e një vendi relativisht të vogël, si RSH.

Me fjalë të tjera, për shkak të këtij Samiti, Tirana do të vendoset në “top-news” të Medias, Kancelarive globale, Institucioneve, ekspertëve/kolegëve në Uashington, Bruksel, Berlin, etj., si dhe opinionit publik përtej vendeve të Europës Juglindore.

Prandaj, për sa ky Samit mbart vëmendje gjeopolitike si dhe promovon interesat kombëtare, patjetër duhet përshëndetur pa asnjë hezitim kuraja, gjetja, edhe sfida veçmas edhe të gjitha së bashku, pra thjesht dhe vetëm pasi një ngjarje e madhe i bën nder flamurit tonë Kombëtar, apo jo?

Së dyti, zhvillimi i këtij Samiti në Tiranë, faktikisht e konfirmon Shqipërinë si anëtare serioze dhe të denjë të NATO-s, pasi “RSH demonstroi kohezion dhe mbështetje të pa kushtëzuar ndaj të gjitha angazhimeve dhe projekteve të Aleancës Euroatlantike në interes të sigurisë kolektive (artikulli-5) por edhe në mbështetje pa asnjë kompromis deri në fitoren e Ukrainës, ndaj të keqes së përbashkët, Rosisë – Putiniste”.

Uroj të jem gabim, por ndoshta duhet ri-qartësuar edhe riciklimi i një pikëpyetje “naive, në mos cinike” = A ekspozohet, apo më qartë = A/sa rrezikon Shqipëria nga organizimi i këtij Samiti në Tiranë ?

Përtej mendjeve të ndryshkura, 15 vjet pas anëtarësimit shpresoj të kemi zhvilluar një vetëdije mbarëkombëtare se: “NATO nuk është kurrësi një organizatë bamirësie që dhuron falas ndihma, para apo mbështetje politike”. Në të kundërt, Ajo ka mbijetuar në treg si Aleanca më e fuqishme e historisë së njerëzimit, për shkak të fuqisë së pamposhtur ushtarake që gjenerohet proporcionalisht nga vendet anëtare.

Prandaj e ri-theksoj se nga 2009, kur Shqipëria iu bashkua sigurisë kolektive (artikulli 5), bashkë me përfitimet mbart edhe barrën e rreziqeve dhe përgjegjësi që burojnë nga anëtarësimi. E thënë më qartë, çdo kërcënim ndaj tërësisë territoriale të 31 vendeve të Aleancës është edhe kërcënim ndaj RSH. Pra nëse ky Samit mbart kërcënime për Aleancën, sigurisht përfshin dhe Republikën e Shqipërisë.

Ndërsa, për sa i përket ekspozimit të RSH-së në mbështetjen pa kompromis deri në fitoren ndaj Rosisë – Putiniste, theksoj se Shqipëria sigurisht ka interesa gjeopolitike shtesë, përtej atyre të 31 vendeve të NATO-s. E kundërta, pra një fitore e Rosisë në Ukrainë, do të ishte fatale për rendin Global, Aleancën Euroatlantike por edhe më tragjike për interesat kombëtare të RSH-së në Ballkan, Mesdhe dhe në Adriatik!

Së treti, organizimi i kësaj ngjarjeje madhore në Tiranë e promovon fort rolin edhe peshën që mban RSH në paqen, stabilitetin demokratik dhe axhendën e integritetit Euroatlantik të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe në forcimin e partneritetit strategjik me SHBA/NATO-n.

Nga ana tjetër e kthen Tiranën në qendrën e gravitetit për zhvillimin e projekteve ekonomike të përbashkëta si dhe ndaj kërcënimeve asimetrike, si terrorizmi, mbrojtja kibernetike, emergjencat, ekstremizmit, krimit të organizuar, etj.!

“Samiti për Ukrainën, gjetje e mençur dhe sfidë serioze e RSH”



Me këtë rast sjell në memorien strategjike edhe rolin aktiv të Shqipërisë, jo vetëm për organizimin e këtij Samiti, por dhe performancën dinjitoze në Këshillin e Sigurimit të OKB-së; për solidaritetin e pa kushtëzuar ndaj vendimmarrjeve dhe angazhimeve të SHBA/NATO-s; mbështetjen për refugjatët si dhe kontributeve ushtarake më shumë se modeste që MM/RSH vijon t’i japë Ukrainës martire. Së katërti, thënë sa më sipër, sigurisht për këto ngjarje me peshë gjeopolitike dhe interesa të larta kombëtare, KURRSESI nuk vlejnë as ekzagjerimet bolshevike, as privatizimi i axhendës euroatlantike, as i dashurisë për mëmëdhenë. POR vetëm dashuria, nderimi dhe përlësia për vendin, vizioni dhe përgjegjësia e lartë shtetërore ndaj interesave kombëtare, besimi në vlerat demokratike si dhe “bekimi” nga/ndaj partneritetit strategjik me SHBA-të, NATO-n dhe BE-në.

Duke përshëndetur organizatorët e këtij Samiti në Tiranë si dhe rreshtimin e Shqipërisë në listën e mbi 20 vendeve të NATO-s që arritën 2 % të GDP-së në 2024, ndërtimin e Bazës Ajrore të Kuçovës, etj., në krye të axhendës kombëtare, do duhet të mbetet përditësimi i mëtejshëm i Sistemit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, duke modernizuar konceptin, strukturat, kapacitetet, balancat e pushteteve dhe kulturën euroatlantike të bashkëpunimit.

Së pesti, gjetjet e Samitit në ditën e dytë do të shërbejnë si mesazhe Euroatlantike ndaj 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor, për të mos u (sh) përdoruar për interesat e Putinizmit; të mos frymëzojnë radikalët e tipit Dodik në Bosnjë; as axhendën e pushtetarëve të korruptuar dhe grupeve kriminale; si dhe të mos të kërcënojë ushtarakisht status-quonë gjeopolitike dhe investimin e USA/NATO për paqen e rajonit! Me këtë rast do të sillja në kujtesë se, historitë e pas-luftërave na tregojnë, se marrëveshjet për paqe të qëndrueshme, nuk kanë për të funksionuar, pa shtruar si themele një paketë masash të mirëbesimit reciprok mes popujve. Krimea, mbetet një mësim i madh, mbasi marrëveshja e Minsk/2015, jo vetëm që nuk “polli” paqe por po shpaguehet me gjakun e qytetarëve Ukrainas dhe Rusë!

Prandaj, në statusin e “Ekspertit të Sigurisë Kombëtare, Rajonin dhe NATO-n”, do ri-sugjeroja miqësisht aktorët zyrtarë, faktorët relevant dhe kolegët në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, që perspektivën e paqes në rajon do duhet ta para-kushtëzojnë me rikthimin e dy Masave bazë të Mirëbesimit Reciprok (CSBM),

nëpërmjet të cilave vendeve “t’u imponohet” që: (1) do të ruajnë balancat e fuqisë ushtarake, deri në nivelin që të mos kërcënojnë reciprokisht integritetin territorial; (2) të mos vendosin instalime dhe aktivitete ushtarake (20 km distancë ajrore/5km tokësore), në kufijtë ndërshtetërorë. Më tej këto dy kushte bazë do të duhen të monitorohen nga USA/NATO/BE, të cilat mbeten faktor kritik për paqen dhe integritimin e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Në shtesë, në kontekstin e kohës/momentit, ky Samit mbahet 2-javë mbas Konferencës së Sigurisë në Mynih-ut, dhe do t’ju bashkohet mesazheve: “për të forcuar më tej kohezionin mes vlerave, duke mbështetur pa asnjë kompromis Ukrainën deri në fitoren ndaj Rosisë, por edhe për përmirësimin e fuqisë ushtarake në mbrojtje të paqes, vlerave Euroatlantike dhe interesave gjeopolitike të USA/NATO-s/BE-se në rajon!”

Po ashtu, ky Samit mbahet vetëm 4 ditë pas 2-vjetorit të dështimit turpëruar të luftës neo-naziste të Rosisë - Putiniste, e cila jo vetëm nuk e pushtoi dot as me lule dhe valle për dy muaj, dhe as me tanke, raketa dhe bajoneta as për 2 vjet Ukrainën. Por mbas 730 ditë/net luftime po zvarritet si terroristët e Hamasit në llogoret e Zaporizhias, Oblastes, Bakhmutit, Khersonit, etj., duke lënë në fushëbetejë mbi 320 mijë të vrarë, duke humbur mbi 50 % të territoreve të pushtuara dhe iniciativën strategjike të luftës si dhe betejën për të sfiduar rendin e sigurisë globale, kohezionin vlerat dhe fuqinë ushtarake të aleancës trans-atlantike.

Së fundmi, duke e uruar mirëseardhjen Presidentit Zelensky si dhe suksese pjesëmarrësve, besoj se gjetjet e këtij Samiti do të shërbejnë për të zgjuar dhe zhvilluar një leadership të fortë me vizion dhe përgjegjshmëri të lartë, vullnet, solidaritet, projekte si dhe mbështetje financiare për modernizimin aftësive ushtarake për t’u përballur me rreziqet konvencionale si dhe kërcënimet ndaj sigurisë, paqes, prosperitetit dhe stabilitetit demokratik përfshi/ përtej hapësirës se Europës jug-lindore.

Po ashtu, shpresoj që mesazhet e këtij Samiti nga Tirana do t’ju shërbejnë elitave mendjehapura në kryeqytetet e Europës Juglindore se: paqja mbetet opsion dhe misioni i vetëm, në mënyrë që siguria të konsumohet përtej historisë së përgjakshme, në interes të sigurisë së jetës, prosperitetit të qytetarëve si dhe perspektivën Euroatlantike për 6 vendet e Ballkanit Perëndimor.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Gruaja, projeksioni i së ardhmes, jeta që lind jetën

E gjithë bota po përpohet nga një realitet që “vret”. Çdo ditë përballemi me ngjarje tronditëse, ku qendër e vëmendjes është vrasja, vetëvrasja e një gruaje. A është ky një fenomen shqiptar, apo e gjithë bota e globalizuar po e përjeton si një ‘sindrom’, shkaku i së cilës je ti. Ti, që nuk dite të sillesh si bir, bashkëshort, baba. Ti, që nuk mësove të duash dhe të sillesh si një ‘zotëri’ dhe përballë krijesës tënde.

Unë, nëna e një djali, që u rrita nga një baba, i cili më mësoi formulën e lumturisë së një vajze, që ec pa u stepur përballë çdo stuhie. Bija e një nëne që i mësoi një burri se si të dojë gjakun e gjakut të tij.



Të lutem, dua dhe përkrahe sot, sepse nesër...

Kur të kthehem pas vizitës time të parë nga gjinekologu pasi të më ketë thënë se është vajzë, të lutem gëzohu. Nëse ka ndonjë këshillë që do të ta jepja edhe në emër të tim ati, është: gëzohu pamasë, se të jesh i sigurt do jesh pika e saj e dobët.

Kur të jemi në dhomën e spitalit dhe doktori të ta japë ta mbash në krahët e tua për herë të parë, premti se do ta duash më shumë se unë, ky është shpërblimi që meriton t’ia thuash pas 9 muajve që unë do ta kem mbajtur.

Ajo nuk do jetë gjithmonë e vogël, kështu që jam e sigurt që kur të rritet do ta kujtoj mirë puthjen në dorë prej princeshe, që ti do t’ia bësh ritual.

Kur ajo të vijë në shtëpi nga shkolla dhe të bërtasë se shoqja e saj e ka sharë për modelin e ri të flokëve, edhe pse mund të të duket një muhabet prej “mami”, më beso, pasi t’i kesh thënë se ajo duket shumë e bukur, një detaj i tillë do ta bëjë atë të mbështetet fort tek ty, duke e veshur me vetëbesim.

Bëji një natë palaçinkat e saj me Nutella, vizato kukullat e saj të preferuara e lëre ta mbështesë kokën në shpatullën tënde e ta zërë gjumi aty, a ka dashuri më të madhe?!

Mësoje për të bukurën, natyrën, pikturën, muzikën, ushqejat shpirtin me art, dhe bëje të qeshë shumë. Kujtoja herë pas here se sa e do. A do ketë gjë më të bukur se shkëlqimi që do marrë syri i saj?!

Kur të jetë në moshën e adoleshencës, kritikoje më pak e dëgjoje më shumë, ajo ka nevojë të shprehet për të gjetur një fole. Edukoje me dashuri, është forma më efektive që thyen çdo mur, më beso, se sa e butë do të jetë edhe ajo me reagimin e saj, ti je ai që përherë do t’ia vjedhësh buzëqeshjen.

Kur të më tregojë mua se ajo ka një shok, mos u bëj protektiv, e di... do e gëlltisësh me zor si lajm e atë natë nuk do të të zërë gjumi, por merre një natë në restorantin e saj të preferuar e thuaj se të jesh versioni më i mirë i vetes është zinxhiri më i fortë që mund të krijojë me rrethin e jashtëm.

Të lutem, thuaj se nuk të intereson nëse portofoli i atij djali është plot apo gjysmë bosh, për aq kohë sa ai të këtë zemrën plot bëje një shoqëruar të një shpirti të bukur si të saj.

Thuaj se ajo nuk është një njeri i zakonshëm në jetë, por është



produkt i një lumturie, e të tillë e meriton çdo ditë të jetës, duke mos toleruar të trajtohet ndryshe. Mësoje se të japësh shumë dashuri do të thotë edhe që ajo dashuri të të kthehet çdo ditë që ajo do të hapë sytë.

E në ditën e saj të shënuar, jepi unazën time, e thuaj se aty e ka gjenezën ajo, prej dashurisë së stërgjyshes, gjyshes dhe nënës së ardhshme e gruas tënde aktuale.

Sot, jam unë ajo që ti ke zgjedhur si nënën e vajzës tënde të ardhshme.

Bëhu ti, babai i një vajze që të jetë kurorë dashurie e rrethuar me jetë të lumtur. Bëhu ti, babai, strehëza tek e cila do gjejë paqen në kohë suferinash.

Dhe atëherë kur “ata” të thonë:

Një grua..., nuk është aq e fortë, sa është një burrë.

Një grua..., nuk mund të bëjë, atë që mund ta bëjë një burrë.

Një grua..., nuk është aq e mençur nga ç’ mund të jetë një burrë.

Një grua..., nuk ka vlerë sa ç’ ka një burrë.

Një grua..., me lindjen e saj, i bën të qajnë e të pikëllohen të gjithë.

Një grua..., është e derës së huaj.

Një grua..., rol të vetëm në jetë ka shërbimin ndaj burrit.

Por, ata që thanë e thonë kështu, me siguri nuk e dinë, që po ta dinte një grua, që ata do rriteshin e do flisnin ashtu, ajo grua do zgjidhte të mos bëhej kurrë nënë.

Mos provokoni që nëna juaj të pendohet që ju solli në jetë, sepse ky është dënimi më i madh që mund të marrësh nga jeta. Ndaj ti, krijesa që lind jetën bëhu...

Gruaja që gratë e tjera mund të të besojnë. Gruaja që ka guximin të flasë kur i cenohet liria.

Gruaja që qëndron krah një gruaje tjetër që po cenohet. Gruaja që sheh vuajtjen e një gruaje tjetër. Gruaja që guxon të denoncojë dhunën. Gruaja që qëndron krah një gruaje që dhunohet. Gruaja që i cakton vetes qëllime të larta. Gruaja që ndihmon gratë e tjera të arrijnë këtë pavarësi.

Gruaja që zgjat dorën për gratë që rrëzohen nga jeta. Gruaja që gjithë vajzat e vogla do të të shohin si shembull se si duhet të jetë një grua e fortë, e pavarur, që qëndron e palëkundur mbi këmbët e saja.

Mos ndrysho se të diktohet...

Mos ndrysho mënyrën se si sillesh, se si dukesh, thjesht sepse partneri jot i do ato “ndryshe”.

Mos u tërhiq nga shoqëria dhe vendet që preferojë më parë, sepse ai bëhet xheloz.

A mos vallë ju duket normale kjo gjë?!?

A ju duket normale të ndryshoni identitetin tuaj sepse tani jeni në një lidhje?!

Mos gënjeni veten nëse mendoni se vetëm kështu do të dukesh femër më e mirë në sytë e tij.

Mos gënjeni veten, duke u përpjekur të ndiheni e vlerësuar në sytë e dikujt, nëse ai ende nuk e ka bërë.

Mos u mundoni të jeni ajo që ai dëshiron, nëse deri tani nuk të ka dashur për atë që je.

Kush nga ju e ka bërë këtë, e ka bërë sepse ka qenë e detyruar, sepse kështu ka dashur partneri.

Mos zgjidh njeriun që dëshiron që të zhdukë pa përsosmëritë e tua...

Mos zgjidh atë që dëshiron të zhdukë versionin e asaj gruaje që ishe dikur, e duke dashur të të shndërrorë në dikë që ti nuk je, vetëm që të mbushet egoja e tij.

Zgjidh dikë që të do për atë që ishe, që ditën e parë që të shprehu dashurinë.

Mëso të jesh grua...

Unë mësova të jem grua nga mënyra sesi kjo botë më ‘rriti’. Bota më thoshte të heshtja..., kurse unë zgjedha të flisja.

Bota më thoshte të isha e dobët, sepse ashtu është natyra ime si grua..., kurse unë zgjedha të jem e fortë, pikërisht siç është një grua.

Bota më thoshte të ulja kokën..., kurse unë zgjedha të ngrihesha, shumë më lart se ç’ ishin kokat e tyre.

Të jesh grua, do të thotë të të rrisë kjo botë, që të jesh një Asgjë... dhe të bëhesh një Gjithçka.



Besëlidhja e Lezhës, produkt i aristokracisë dhe fisnikërisë shqiptare

Çlirimi i vendit me kryengritjen e përgjithshme të vitit 1443, ishte një fitore historike që duhej mbrojtur e çuar më tej. Përvoja e deriatëhershme shqiptare e ballkanike, sidomos kryengritjet e viteve '30 në Shqipëri, kishin treguar se fuqisë ushtarake më të madhe të kohës, Perandorisë Osmane, nuk mund t'i bëhej ballë pa bashkimin e forcave të brendshme politike, ushtarake dhe ekonomike, si dhe pa bashkëpunimin me vendet e tjera.

Prandaj Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ndoqi një politikë të brendshme e të jashtme shumë aktive. Më mirë se kushdo tjetër ai e kuptoi se për shqiptarët nuk do të kishte perspektiva për mbrojtjen e viseve të lira, duke qëndruar në pozitë të vjetra, pa kapërcyer copëtimin politik të vendit në një varg zotërimesh të pavarura dhe pa një bazë organizative të qëndrueshme, e cila do të bashkërendonte burimet njerëzore, ushtarake e ekonomike të vendit, si dhe gjithë veprimtarinë e zhvilluar në rrafsh të brendshëm me atë të ndërmarrë në rrafsh ndërkombëtar.

Për zgjidhjen e këtyre detyrave, si hap të parë e të domosdoshëm Skënderbeu gjykoi mbajtjen e një kuvendi të përgjithshëm, ku të përfaqësoheshin drejtuesit e zotërimeve të pavarura dhe fisnikë të tjerë të vendit. Për këtë, ai zhvilloi paraprakisht me ta takime vetjake, si rrjedhojë e të cilave u vendos që të mbahej në Lezhë një kuvend i fisnikëve shqiptarë.

Kuvendet krahinore e ndërkrahinore të fisnikëve, të klerikëve apo të pleqve, ishin një traditë e njohur kombëtare e shqiptarëve e trashëguar ndër shekuj, nëpërmjet të cilave realizohej bashkëpunimi dhe bashkimi i shqiptarëve. Një kuvend me një përfaqësi kaq të gjerë kombëtare, që u vendos të mbahej në Lezhë nga shqiptarët, është i pari që njihet deri tani në historinë e tyre.

Lezha kishte një pozicion gjeografik të favorshëm për mbajtjen e Kuvendit. Ajo ndodhej në afërsi me zotërimet e pjesëmarrësve kryesorë të Kuvendit, ishte e veçantë nga zotërimet e tjera të Venedikut dhe kishte lidhje të ngushta ekonomike me viset e çliruara shqiptare, veçanërisht me ato të Kastriotëve.

Për më tej, duke qenë Lezha nën zotërimin Venecian, mënjanoreshin mosmarrëveshjet e pakënaqësitë që mund të lindnin ndërmjet sundimtarëve shqiptarë për vendin ku duhej të mbahej Kuvendi, si dhe në drejtim të marrëdhënieve me Republikën e Venedikut. Mbajtja e tij në Lezhë ishte si një thirrje miqësore për bashkëpunim në luftën kundër osmanëve, që fisnikët shqiptarë i drejtonin me këtë rast Republikës së Shën Markut.

Kuvendi i fisnikëve shqiptarë u mbajt, më 2 mars 1444, në Katedralen e Shën Kollit në Lezhë. Në të morën pjesë udhëheqës të kryengritjeve të mëparshme antiosmane, si dhe pjesëtarë të tjerë të aristokracisë shqiptare. Midis tyre ishin: Skënderbeu, Gjergj Arianiti, Andre Topia (bashkë me dy djemtë, Kominin e Muzakën dhe të nipin Tanushin), Gjergj Stres Balsha, Nikollë e Pal Dukagjini, Pjetër Spani (bashkë me katër djemtë, Aleksin, Bozhidarin, Vruon dhe Mirkon), Lekë Zaharia, Teodor Muzaka i Riu (dhe pjesëtarë të tjerë të kësaj familjeje), Zahari Gropa, Lekë Dushmani bashkë me Pjetrin e fisnikë të tjerë fqinjë me ta, Stefan Gjuraşi (Cërnojeviçi bashkë me bijtë e tij, Gjergjin e Gjonin) etj.

Skënderbeu mbajti fjalën e hapjes në Kuvend dhe u ndal në domosdoshmërinë dhe rëndësinë e bashkimit politik të shqiptarëve. Pjesëmarrësit diskutuan format e bashkëpunimit dhe rrugët për realizimin e bashkimit politik të tyre, në themel të të cilit vunë institucionin më të rëndësishëm kombëtar, atë të besës. Ata institucionalizuan Kuvendin si forumin politik më të lartë vendimmarrës të fisnikëve shqiptarë.

Kuvendi vendosi që bashkimi i shqiptarëve të bëhej në formën e një besëlidhjeje politike ndërmjet drejtuesve të zotërimeve të lira dhe fisnikëve të tjerë të vendit, që u njoh me emrin Besëlidhja Shqiptare e Lezhës. Ajo ishte një aleancë politike e ushtarake. Si kryetar i saj u zgjodh Skënderbeu, kurse si institucioni më i lartë vendimmarrës u bë Kuvendi i anëtarëve të Besëlidhjes, i cili do të mblidhej herë pas here për çështje të rëndësishme.

Nëpërmjet Kuvendit realizohej dhe shprehej bashkimi i shqiptarëve.

Vendim tjetër shumë i rëndësishëm i Kuvendit ishte krijimi i ushtrisë së përbashkët dhe caktimi i Skënderbeut si komandant i përgjithshëm i saj. Ushtria e Besëlidhjes përbëhej nga dy pjesë: nga forcat e përhershme dhe nga ato të përkohshmet që mobilizoheshin vetëm në rast lufte.

Ushtria e përhershme formohej me luftëtarët që fisnikët shqiptarë dërgonin pranë komandantit të përgjithshëm sipas një kuote të caktuar për secilin, si dhe nga ushtarët që mobilizonte vetë Skënderbeu. Këta formonin bërthamën kryesore të ushtrisë së përhershme, e cila vazhdimisht ishte në gatishmëri luftarake dhe në mbrojtje të kështjellave, veçanërisht atyre të brezit kufitar lindor nga vinin zakonisht ushtritë osmane.

Detyra kryesore e ushtrisë së përhershme ishte mënjanimi i



sulmeve të befasishme të trupave osmane mbi viset e lira shqiptare dhe pengimi i depërtimit të tyre në thellësi të vendit, derisa të mobilizoheshin ushtria e përkohshme. Kjo formonte pjesën më të madhe të ushtrisë së Besëlidhjes dhe përbëhej nga luftëtarët që mobilizoheshin përkohësisht, kur parashikohej fillimi i sulmeve të ushtrive armike. Në ushtrinë e përkohshme përfshiheshin të gjithë banorët e viseve të lira që ishin në gjendje të përdornin armët.

Në rast nevojë ushtria e përbashkët mbronte vendin nga pushtuesit osmanë e veprimet armiqësore të vendeve të tjera, si dhe interesat e zotërimit e secilit anëtar të Besëlidhjes. Për të përballuar shpenzimet e mbajtjes së ushtrisë, të armatimit të saj, etj., Kuvendi vendosi që pranë Skënderbeut të krijoheshin një arkë e përbashkët. Fondet monetare të saj do të formoheshin nga ndihmat në të holla që secili anëtar i Besëlidhjes do të jepte sipas një kuote të caktuar nga Kuvendi, nga të ardhurat e kriporeve të Shën Kollit, që kishin Kastriotët pranë grykëderdhjes së lumit Mat, nga taksat doganore, si dhe nga tregtia e drithit, e metaleve etj.

Besëlidhja e Lezhës u krijua si një aleancë politike dhe ushtarake

e luftës së përbashkët të fisnikëve shqiptarë kundër pushtuesve osmanë. Në krye të Besëlidhjes dhe të organeve ushtarake e financiare të saj u caktua një udhëheqje e vetme, e kryesuar nga Skënderbeu. Prandaj, edhe pse Besëlidhja kishte karakterin e një aleance politike e ushtarake, me vendimet e Kuvendit të Lezhës u bë një hap i madh e vendimtar përpara drejt bashkimit politik të vendit dhe krijimit të një pushteti qendror për të gjitha viset e lira shqiptare, pushtet që u përfaqësua nga Gjergj Kastrioti-Skënderbeu.

Anëtarët e Besëlidhjes Shqiptare synonin që, në kuadrin e saj, të ruanin autonominë e tyre dhe Skënderbeu, si kryetar i saj, të mos ndërhynte në zotërimet e të tjerëve, por të ishte si “i parë ndërmjet të barabartëve”. Secili prej anëtarëve të Besëlidhjes kishte trupa të veçanta për të mbrojtur zotërimet e interesat e veta dhe ruante të drejtën të kishte marrëdhënie vetjake me vende e forca të tjera politike jashtë Besëlidhjes. Realisht vendimet e Kuvendit i dhanë Skënderbeut një pozitë të veçantë ndaj fisnikëve të tjerë shqiptarë, dhe këta, siç shprehej Gjoni Muzaka, në kushtet e rrezikut të pushtimit osman, ishin të detyruar “t’i bindeshin” atij.

Kryengritja fitimtare e vitit 1443 dhe Kuvendi i Përgjithshëm Shqiptar i 2 marsit 1444 shënuan një kthesë vendimtare në luftën kundër pushtimit të huaj osman dhe hapën rrugën e zhvillimit të vrullshëm të procesit të bashkimit politik dhe shpirtëror të banorëve të krahinave të ndryshme shqiptare. Gjergj Kastrioti-Skënderbeu doli në krye të jetës politike e ushtarake të vendit jo rastësisht. Për këtë ndikuan: roli i veçantë i tij në organizimin e Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1443, pozita gjeografike e shtetit të Kastriotëve (që ishte në qendër të viseve të lira dhe nëpër të kalonin rrugët më të rëndësishme që lidhnin krahinat veriore me jugoret dhe lindoret me perëndimoret), zotërimi prej tij i Krujës, kështjellës me pozicionin gjeografik më të përshtatshëm për administrimin e të gjitha viseve të çliruara, dhe për të hyrë në kontakte të shpejta me shtetet e huaja antiosmane, si dhe lidhjet e shumta farefisnore e martesore të Kastriotëve me shumë familje fisnike të tjera, si Muzakajt, Arianitët, Stres Balshajt, Gjuraşët (Cërnojeviçët), Balshajt etj.

Mbi të gjitha ishte personaliteti i vetë Skënderbeut që bëri të mundur daljen e tij në krye të jetës politike e ushtarake të Shqipërisë. Më tepër se cילו anëtar tjetër i Besëlidhjes Shqiptare, Skënderbeu kishte të gjitha cilësitë për drejtimin me sukses të luftës. Ai i njihte shumë mirë mundësitë ekonomike, financiare e ushtarake të vendit të vet. Ndërsa karriera e tij në radhët e kuadrove ushtarakë osmanë e kishte bërë Skënderbeun njohës po aq të mirë të fuqisë, organizimit dhe të artit ushtarak të osmanëve.





Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

(Në kuadrin e 80-vjetorit të varjes në litar)

Në litar, ditën e fundit të dimrit 1944

Me përfundimin e Operacionit të Dimrit 1944, në Tiranë, më 29 shkurt 1944 fashistët gjermanë në bashkëpunim me xhandarmërinë shqiptare dhe komandantin e saj, shqiptarin Xhelal Staravecka kapën dhe ekzekutojnë me varje në litar luftëtarin Muhamet Gjollësja. Veprimtaria revolucionare e Muhametit njihej në Gjirokastrë, Vlorë, Durrës, Berat, Shkodër, Tiranë, Mat dhe në të gjithë vendin. Ai punoi e militoi për organizimin e kryengritjes së përgjithshme, duke goditur pa mëshirë pushtuesit e spiunët ballisto-zogistë pa mëshirë, për ta parë Atdheun të lirë. E ku nuk ndihej krisma e revolverit të labit nga Lazarati, duke sinjalizuar kudo fundin e nazifashistëve dhe të bashkëpunëtorëve të tyre. Veprimtaria e antifashistit Muhamet Gjollësja i tërbonte tradhtarët xhandarë Hysni Dema e Xhelal Staravecka, të cilët me dijeninë e Prefektit Qazim Mulleti, do ta kapnin dhe ta mposhtnin luftëtarin. Muhameti u arrestua në Tiranë kur ishte dërguar nga komanda partizane për punë, por u kap tradhtisht nga xhandarët që i ishin qepur nga pas. Fashistët shqiptarë e arrestuan në darkën e 28 shkurtit. Gjatë natës në mënyrë barbare e kriminale që i karakterizonte, pa gjyq, e varën në litar në mëngjes në skelën e një ndërtese që po ngrihej në Pazarin e Ri të Tiranës.

Muhamet Gjollësja para litarit qëndroi burrërisht dhe heroikisht. Edhe me litarin në fyt ai thërriti “Rroftë Shqipëria e lirë e popullit, poshtë tradhtarët!”. Muhamet Gjollësja mbajti qëndrim burrëror, përpara asaj skene tragjike. Këtë e panë mirë qytetarët e Tiranës, por dhe tradhtarët. Muhameti para litarit, me fytyrën e bardhë dhe simpatike, me flokët e verdhë, me veshjen elegante, me shikimin e tij të egër dhe përbuzës, por që zakonisht ishte i ëmbël dhe i butë, me zërin e tij kumbues, bëri që xhelatët shqiptarë të tmerroheshin. Muhameti e donte shumë atdheun dhe popullin, të cilëve u kishte kushtuar gjithë zotësinë dhe energjinë e tij të madhe. Ai ra si bien trimat për lirinë dhe lumturinë e atdheut e të popullit shqiptar. Në shekuj është dhuruar jetë për mbrojtjen e Atdheut. Por këtu ka diçka mistike në respektin e kësaj zemërgjerësie. Antifashistët e donin Shqipërinë jo vetëm të çliruar nga okupatori por dhe të lirë shpirtërisht, ndaj kundërshtimi i tyre na çon larg, te tradita e etërve, zakoni i lirisë.

Formimi i tij si patriot...

Muhamet Gjollësja ka lindur në fshatin Lazarat të Gjirokastrës, më 1914. Babai i tij, Bido Latifi, kishte qenë një burrë bujar që nderohej nga fshatarët dhe bashkëqytetarët për ndershmërinë e tij dhe si burrë zakoni. Patrioti zemërmadh Bido Latifi (Gjollësja) shquhej si pjesëmarrës në pritjen e plakut të urtë, patriotit të madh Ismail Qemali, më 28 Nëntor 1912, si kryetar i delegacionit të Lazaratit në ditën e madhe të shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, në ditën madhështore të ngritjes së flamurit në Vlorën heroike. Patriotin Bido e shohim pjesëmarrës me armë në dorë krah Selam Musait me trima të krye të 36 djemve e burrave lazaratas në Luftën e Vlorës 1920, si dhe në vitin 1924 përkrahës aktiv me shumë bashkëfshatarë të lëvizjes demokratike noliste dhe të qeverisë që solli revolucionin demokratiko-borgjez të atij viti. Babai i Muhametit kishte miqësi të ngushtë me Siri Peçin dhe me Shefqet Peçin nga Picari. Këtë miqësi patriotësh babai e kultivoi edhe tek i biri, te ky Promete zemërzjarrtë dhe gojëmjaltë të epopesë së madhe të LANÇ-it. Aspekti cilësor i këtyre patriotëve konfirmohet te ndershmëria, heroizmi, burrëria, karakteri luftarak, trimëria. Miqësia, virtyti kryesor dhe ekuilibri, nota më e dukshme e tyre. Kjo “balancë nderi” është celebrimi i vlerave të tyre.

Muhameti në vitin 1929, mbaroi shkollën fillore në Delvinë, dhe nisi studimet në Institutin Teknik Superior në Tiranë, falë përpjekjeve të mundimshme të babait, i cili shikonte tek i biri zgjuars, shkathtësi, vullnet, guxim e vendosmëri. Edhe këtë shkollë djaloshi lazaratas e mbaroi me rezultate të larta, në vitin 1936. Pushimet verore në Delvinë ai i kalonte me shokët e tij të vjetër, ishte shpirti i tyre, i cili me autoritetin e zotësinë dhe fjalën e tij të zjarrtë mudohej ta mobilizonte për vepra atdhetare. Muhamet Gjollësja, kur ishte nxënës në Teknikën e Tiranës, ishte një nga nxënësit më të shquar të saj. Ishte i pjekur për moshën, serioz kur fliste mbi çdo gjë, kishte zjarr dhe urrejtje për

Muhamet Gjollësja, dëshmi e celebrimit të vlerave dhe lirisë



Dëshmori Muhamet Gjollësja

sunduesit e kohës. Ai ishte një i ri me mendime përparimtare dhe i palodhur për të folur, por me përbuzje për njerëzit e regjimit të vjetër. Ai ishte i sigurt në ato që thoshte, ishte nxënës i rregullt në mësim, ishte i dhënë pas librave, i matur dhe i dëgjueshëm me shokët, por i zjarrtë për të treguar dashuri ndaj të varfërve dhe urrejtje ndaj pasanikëve, grabitqarë, e pushtuesve. Ai një ditë u bë revolucionar i vendosur. Në vitin 1937, Muhameti emërohet zëvendës inxhinier për Punët Botore në Bashkinë e Beratit, ku tregoi aftësi e kompetenca profesionale.

Muhameti antifashist dhe luftëtar

Pushtimi fashist i 7 prillit 1939 e gjen Muhametin me shumë të rinj të tjerë në ballë të demonstratave që kërkoreshin armë për të pritur pushtuesit fashistë në Durrës, por rezistenca popullore ishte sabotuar me kohë nga mbreti Zog. Në vitin 1939 si inxhinier i talentuar, emërohet në zyrën e Punëve Botore në Shkodër. Edhe këtu zhvilloi më tej veprimtarinë patriotike, duke depërtuar në masën e të rinjve, ku njihet e bashkëvepron me të rinj revolucionarë e antifashistë si Perlat Rexhepi, Branko Kadia etj. Veprimtaria ra në sy dhe duke ndjerë peshën e aktivitetit të tij në masën e popullit liridashës të Shkodrës, Muhametin e transferojnë në zyrën e Botores në Mat. Këtu puna i dha mundësi këtij njeriu të lavdishëm të njihej me shumë njerëz të shtresave e moshave të ndryshme për të thelluar më shumë aktivitetin e tij kundër fashizmit. Ai hyri lirshëm në zemrën e popullit matjan, e donte Shqipërinë të lirë, pa pushtues të huaj dhe gjakprirës të popullit. Në këtë zonë Muhameti bëri një punë të madhe për të ngritur popullin në luftë kundër fashizmit dhe luftoi heroikisht me armë në dorë, bashkë me çetat partizane, në Krujë në Qafë Shtamë dhe në Mat. Kështu inxhinieri u bë i penës dhe i pushkës, sepse Muhameti, ishte djalë i popullit me cilësi të rralla, njeri i thjeshtë, energjik, i zjarrtë, i dashur, i ëmbël dhe mikpritës me shokë, i lidhur me masat dhe i kujdesshëm për njerëzit. Me të gjitha këto cilësi të pajisura ai fitoi shumë shpejt respektin dhe simpatinë e popullit të Matit, duke e admiruar “inxhinierin” e ri.

Më 18 korrik 1942 krijohet çeta partizane e Matit, ku Muhameti bëhet një nga anëtarët më aktivë të tyre dhe merr pjesë me guxim në shumë aksione si protagonist i tyre. Me

guxim të rrallë informonte vijimisht, duke shkruar dhe në Tiranë, organet qendrore për lëvizjet e armikut, për spiunët e tij dhe prej andej merrte detyra për të goditur më me guxim pushtuesit. Si anëtar i devotshëm dhe i paepur i çetës partizane të Matit, ai dha një kontribut të çmuar në organizimin e luftës popullore të Matit, të 31 korrikut 1943, që tronditi thellë pushtuesit fashistë dhe shërbëtorët e tyre. Megjithatë në një këmbë të sëmurë që në fëmijëri nga një infeksion që e mundonte, ai nuk u dha asnjëherë para çdo vështirësie dhe nuk e ndërpreu për asnjë çast aktivitetin në shërbim të LANÇ-it. Me guximin e largpamësinë që e karakterizonte, Muhameti është ballafaquar disa herë me Abaz Kupin, duke e demaskuar hapur veprimtarinë e tij si bashkëpunues i nazifashistë. Në vijim të veprimtarisë së tij si partizan aktiv i çetës së Matit, merr pjesë së bashku me çetën e Dibrës nën komandën e shokut Haxhi Lleshi në aksionin e çlirimit të qytetit të Krujës. Si bir i Shqipërisë Muhameti kishte një shpirt të pastër shqiptari, i cili pulsoi më fort duke ushqyer flakët e idealit kur atdheu ishte në rrezik.

Në kujtimet e një heroi

Bashkëluftëtari i tij, Heroi i Popullit Shefqet Peçi, në librat e tij për luftën, sjell një fragment kuptimplotë për Muhametin, ku theksonte se “kishte cilësi të mira, por ai, duke qenë njeri i vendosur, nuk e përfillte punën e armikut...”. “Më kujtohet një rast në prillin e vitit 1942, kur me Muhametin ishim në hotel ‘Adriatiku’. Muhameti filloi siç e kishte zakoni, të fliste me zë të lartë, fliste me urrejtje për fashizmin dhe për ata që i shërbenin me zell armikut. Ai fliste e fliste dhe zërin e ngrinte sa më shumë. Dukej sikur do të përpinte fashistë e spiunë. Unë, duke parë se zëri i tij sa vinte e ngrihej, i thashë: - Muhamet, ule pak zërin se këtu në hotel mund të ketë dhe agjentë që përgjojnë dhe mund të na dëmojnë, se unë pikërisht këtu jam kapur dhe arrestuar në kohën e Zogut, më 1937. Por Muhameti, si gjithnjë, me nënvleftësim për armikun më tha: -Armiku ka filluar tashmë ta humbasë toruan dhe përpigjet të ruajë kokën e tij, nuk ka nge të na dëgjojë ne. Unë e këshillova rishtas: - Muhamet, duhet kujdes në këto punë, dhe pikërisht sepse armiku mund të ketë humbur toruan prandaj duhet më kujdes të kemi ne.

Muhameti në këtë kohë nxori një fotografi të tij, dhe mbrapa fotografisë shkroi këto fjalë: “Mbaje shok këtë fotografi, mbasi na sot jemi hedhur në fushën e veprimit dhe sakrificë për vumjen e rendit të ri, për shpëtimin e atij, (popullit) që rrota e fatit e ka bërë të shtypur jashtë natyrës. Nuk mund ta kemi jetën me pekule, por si veprim, aksion për të shenjtën liri”. Pastaj më tha: - Ruaje këtë kujtim, në shenjë miqësie të pandarë. E mora fotografinë, e lexova dhe qesha duke i thënë: - More Muhamet, megjithatë unë pikërisht për këtë gjë të këshillova të jemi të kujdesshëm, ti veprime sipas dëshirës sate. Po a ka dokument më të mirë për armikun, që të na dënojë pa gjyq fare të dyve, se sa këto që shkruan ti? Pastaj ne u ndamë si dy shokë të dashur me njeri-tjetrin dhe fotografinë e Muhametit e ruajta me kujdes. Ato ditë fashistët më arrestuan, por nuk me kontrolluan edhe fotografinë e fsheha në këpucë, më vonë e nxora nga burgu për ta ruajtur”.

Përfjetësia

Populli i Lazaratit, figurën e ndritur të birit të tij, e përjetësoi duke i vënë emrin e tij shkollës së fshatit, ku vendosën dhe një stendë me veprimtarinë e tij në muzeun e fshatit. Në hyrje të shtëpisë së tij të lindjes, në Lazarat është vendosur një pllakë përkujtimore. Dita e rënies së tij, 29 shkurti, nga bashkëfshatarësia e tij u caktua si “Dita e dëshmorëve të fshatit”. Muhamet Gjollësja është shpallur dëshmor i Atdheut me vendim nr. 65, datë 2 tetor 1971, të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Gjirokastrë.

Në Tiranë ka një rrugë me emrin Muhamet Gjollësja, si dhe në Pazarin e Ri të Tiranës, dikur ishte një lapidar i madh, ndërsa sot gjendet një shenjë që tregon për varjen në litar të Heroit të Popullit Shyqyri Ishmi dhe të dëshmorit Muhamet Gjollësja.

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Ministria e Mbrojtjes, bashkitë dhe njësitë administrative, si dhe Organizata e Dëshmorëve, në këto vite të demokracisë kanë bërë kujdes për ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të traditave patriotike të popullit tonë, për përjetësimin e ngjarjeve, si dhe të figurave më të rëndësishme, ku gjithnjë e më shumë, është rritur vëmendja ndaj simboleve monumentale në pasqyrimin e historisë së lavdishme të LANÇ-it.

Në vitet e socializmit, krahas vendosjes së pllakave përkujtimore, u ngritën lapidarë, buste, statuja e monumente që i kujtonin udhëtarit apo vizitorit, se shqiptari në jetën e tij ka qenë në luftëra të vazhdueshme për mbrojtjen e dinjitetit, të shtëpisë dhe të territorit të tij.

Simbolet monumentale u vendosën me qëllim për të nderuar veprën e ndritur të dëshmorëve që dhanë gjënë më të shtrenjtë, jetën e tyre për Atdhe. Kështu u bënë emërtime në 2 900 institucione, qytete, kooperativa, reparte ushtarake, rrugë e sheshe me emra dëshmorësh, patriotësh, luftëtarësh e të ngjarjeve historike. Pas çlirimit të vendit u ngritën mbi 12 monumente, 145 buste, 590 lapidarë, si dhe janë vendosur mbi 530 pllaka përkujtimore në të gjithë vendin. Këto simbole monumentale ishin qendra të edukimit patriotik dhe u përdorën në mënyrë të veçantë në festa e ditë jubileare, ku organizoheshin vizita, biseda, ekskursione, koncerte, etj.

Organizimi i aktiviteteve të shumëllojshme pranë objekteve të simboleve monumentale ngjall emocione të thella në ndërgjegjen e pjesëmarrësve, fakt ky që ka ndikuar pozitivisht, në rolin e madh militues që luajnë bustet, monumentet, lapidarët dhe objektet e tjera të simboleve monumentale në njohjen e traditave luftarake të popullit tonë.

Duke u nisur nga këto faktorë dhe me qëllim që të forcojmë e të ngremë më tej rolin dhe nivelin e punës së organeve kompetente që i njeh ligji, si dhe Organizata e Dëshmorëve, në vlerësimin e simboleve monumentale, si një mjet që është në kontakt të vazhdueshëm me ne dhe të përjetësimin, del detyra madhore që të kuptojnë mirë e të trajtojnë drejt rëndësinë dhe efektin e organeve ligjzbatuese ndaj këtyre simboleve. Në këtë drejtim mbetet shumë për të bërë. Aktualisht probleme kryesore që tërheqin vëmendje dhe duhet përqendruar puna në këtë vit të 80-vjetorit të çlirimit të Atdheut, duhet punuar me projekte konkrete me qëllim riaftësimin e tyre dhe përjetimin e ngjarjeve kulmore të kësaj lufte.



Ngritja dhe e vendosja e simboleve si monumente, statuja, buste dhe emërtime të ndryshme bëhet mbi bazën e disa kritereve dhe të miratuara me ligj. Mirëpo këto kritere nuk mbahen parasysh nga organet përkatëse. Janë vërejtur raste që duke mos njohur kriteret, me iniciativa private e lokale, që nuk janë në kompetenca të tyre, janë prishur apo dhe devijuar e premtuar për të ngritur më të kohës, por çdo gjë ka ngelur në premtime. Për disa figura të shquara të rëndësishëm të lëvizjeve patriotike, të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ose të periudhës së pas çlirimit nuk ka buste dhe simbole. Kështu në Tiranë sot nuk kemi asnjë bust të ndonjë Heroine të Popullit, apo të ndonjë dëshmoreje.

Çështja është për të qenë më parimorë dhe të kujdesshëm në zbatimin e përpiktë të kritereve, për të vlerësuar drejt kontributin e çdo personi të rëndësishëm në shërbim të popullit.

Problemi nga organet zbatuese, por dhe nga Organizata e Dëshmorëve do parë dhe trajtuar, të mos gabojmë në vlerësimin e drejtë të fenomeneve, që të nxisim ndjenja jo të mira. Prandaj për këtë problem të rëndësishëm do menduar e vepruar në mënyrë të planifikuar e në bazë të studimeve serioze e me perspektivë.

Është pozitiv fakti që janë përcaktuar dhe piketuar vende

Simbolet e LANÇ-it, evidentim historik i popullit shqiptar



që paraqesin interes për historinë dhe traditat e popullit tonë, megjithëse në këtë fushë ka shumë pika të panjohura, që duhet, pa humbur kohë të zbulohen, të njihen dhe tani për tani të piketohen, por të orientuara nga organet kompetente dhe të përcaktuara me ligj.

Kjo do parë edhe për sa i takon çështjes së ndarjes të objekteve të propagandës monumentale, mbasi shpërndarja dhe vendosja e tyre, që nga objektet më të thjeshta e deri tek ato më të komplikuarat, nuk është bërë gjithmonë me studim dhe me kritere të drejta. Natyrisht ngritja e lapidarëve, ashtu si edhe vendosja e objekteve të tjera përcaktohet nga ngjarjet që janë zhvilluar.

Kështu, në Tiranë, gjatë këtyre viteve janë prishur memoriali i Misto Mames, i Qemal Stafës, i heronjve Shyqyri Ishmi dhe Muhamet Gjollesha të varur në litar tek Pazari i Ri, hequr pllakatet përkujtimore tek mjaft shtëpi, si dhe janë prishur qendra muzeale si shtëpitë e Partisë, të Rinisë, të bazave kryesore të shtypit dhe të ilegalëve të epopesë së madhe të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Në Tiranë gjenden vetëm lapidari i Debatikut në kodrat e liqenit për veprimtarinë revolucionare të fëmijëve e pionierëve, lapidari i Mine Pezës, lapidari i Qemal Stafës që është në degradim, lapidari i “4 dëshmorëve”, lapidari i Vojo Kushi me shokë, përsëri në gjendje të mjerueshme, si dhe lapidari ku u varën Shyqyri Ishmi dhe Muhamet Gjollesha në Pazarin e Ri, si gurë kilometrik të kohëve të shkuara dhe nuk ka më simbole. Gjithashtu ka boshllëqe dhe kufizime në tematikën e përkujtimoreve që i kushtohen ngjarjeve para vitit 1939.

Në Tiranë mungojnë objekte që t’i kushtohen heroizmit dhe kujtimit të grave në luftë. Prandaj mbetet që në të ardhmen të pasqyrohet tematika e trajtimit të veprës dhe figurës së gruas shqiptare në të gjitha llojet e objekteve të simboleve monumentale. Tani për tani kërkohet të mendojmë si organizatë për të vënë në lëvizje sipas ligjeve të miratuara nga parlamenti shqiptar, bashkinë dhe institucione shtetërore dhe private për të ngritur bustet e grave dhe vajzave që janë shpallur heroina dhe gradualisht ndër parqe, lulishte e pika të tjera të vendosen përkujtimore, dhe ku është e mundur, statuja në allçi e çimento, që të simbolizojnë figurën e femrës shqiptare si luftëtare që ka luajtur rol të rëndësishëm në të gjitha periudhat e historisë së popullit tonë.

Problem i rëndësishëm është dhe çështja e paraqitjes së tyre të gjithanshme, Duke i parë me këtë sy këto objekte rezulton se në disa prej tyre mungon përpjekja për origjinalitet kombëtar, dhe disa të tjera nuk janë të tilla që ta tërheqin dhe t’i ngjallin respekt vizitorit, siç po ndodh me lapidarin tek Pazari i Ri, apo dhe të memorialit të tre heronjve të Kodrës së Kuqe, etj.

Kemi dhe objekte, sidomos lapidarë, pllakate përkujtimore e ndonjë bust të projektuar e vendosur keq. Shumica e lapidarëve janë të ndërtuar një lloj, me tulla e suvatim, të veshur me

mermer, apo të lyer me gëlqere, pa asnjë motiv dekorativ apo basoreliev të goditur dhe që të gjitha, thuajse vuajnë nga uniformiteti. Me ndonjë përjashtim, nuk dallohen lapidarët që përkujtojnë të kaluarën nga ato të Luftës Nacionalçlirimtare apo të ndërtimit socialist. Fjala është që çdo epokë të ketë motivet e saj karakteristike. Nga ana tjetër ka lapidarë që nuk i përgjigjen qëllimit për të cilin janë ngritur, sepse nuk simbolizojnë ngjarje apo aksione konkrete. Ka edhe lapidarë që në fakt i kushtohen kujtimit të dëshmorëve të caktuar, por që në të vërtetë nuk njihen nga vizitori, sepse në to nuk ka asnjë mbishkrim sot.

Për sa i përket mbishkrimeve në një pjesë të mirë të objekteve të propagandës monumentale ato nuk janë të goditura. Mbishkrimet vuajnë për mungesën e përmbytjes emocionale dhe si të tilla nuk lënë asnjë mbresë në kujtesën e vizitorit. Shpesh mbishkrimet janë të gjata, të shkruara keq e me gabime. Në shumë objekte ato janë bërë të pa lexueshme dhe në disa të tjera janë prishur. Gjendja flet për kujdesin e pakët që tregohet ende për mirëmbajtjen e objekteve të simboleve monumentale sa që në ndonjë rast, disa prej tyre janë prishur krejtësisht. Kjo pakujdesi vërehet edhe në mirëmbajtjen e objekteve siç janë bustet me rëndësi, lyerja e të cilëve bëhet nga punonjës jo kompetentë të organeve të bashkisë. Për pasojë disa nga bustet për figurat e shquara po dëmtohen dhe po humbasin tiparet e tyre karakteristike. Prandaj, Organizata e Dëshmorëve duhet të ngrejë probleme në bazë të ligjit që organet përkatëse, duke filluar nga paraqitja e përgjithshme e objekteve, sistemimi, zbulurimi i ambientit përreth, ndriçimi dhe vendosja e shtyllës së flamurit kombëtar, është e nevojshme. Çështja e mirëmbajtjes të simboleve ta bëjë me opinion dhe edukatën tek të gjithë anëtarët e organizatës dhe veçanërisht të brezit të ri.

Ka vend të ndërmerren aksione konkrete, duke i konsideruar këto faktorë në edukim. Aksionet të merren për të parë gjendjen e tyre, për të paraqitur kërkesën për rregullim dhe mirëmbajtje, por edhe për ngritjen e objekteve të reja, që lidhen me ngjarje të shënuara. Për të përmirësuar gjendjen mendojmë të propozojmë dhe të merren masa që me rastin e festimit të jubileut të madh të 80-vjetorit të çlirimit të Atdheut të shpallet një aksion i madh nacional për lapidarët dhe simbolet monumentale, për të rregulluar e përmirësuar objektet ekzistuese dhe të vendosen edhe objekte të reja. Për këtë qëllim të kërkojmë nga Ministria e Mbrojtjes, nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me drejtoritë e bashkisë, të marrim masa që brenda një afati të mundshëm, të vishen me mermer të gjithë lapidarët që janë vendosur brenda në qytet dhe në të njëjtën kohë të zëvendësohen lapidarët e pa përshtatshëm. Nga Ministria e Kulturës të bëhen projekte tip (disa lloje) për lapidarët që do të ngrihen, duke patur parasysh faktin që çdo model tip të përmbajë motivet karakteristike të epokave të caktuara nga historia e popullit tonë.

Në kuadrin e aksionit për përmirësimin e gjendjes dhe zhvillimin e mëtejshëm të simboleve monumentale, të mos mbetet asnjë ngjarje pa u përkujtuar dhe fiksuar në ndonjë objekt sado të thjeshtë. Me këtë rast të vendosen pllaka përkujtimore në çdo objekt ku janë zhvilluar ngjarje, emërtime të shkollave, por dhe emërtime të rrugëve me dëshmorë apo dhe ngjarje.

Organizata e Dëshmorëve të kërkojë një bashkëpunim të ngushtë me ministrinë që lidhen me ecurinë e këtij problemi dhe me bashkinë e Tiranës, për të pasur përfaqësuesit e saj për t’u konsultuar në vijimësi. Nga Organizata kërkohet që këtë vit dhe në vazhdim të kemi të regjistruar dhe të pasaportizuar të gjitha objektet e simbolet monumentale dhe të jenë nën kujdesin e plotë të bashkisë, të muzeve, por dhe të Organizatës së dëshmorëve.

Për këtë aksion kombëtar për rregullimin e gjendjes dhe zhvillimin e mëtejshëm të simboleve monumentale të shkruhet herë mbas here në shtyp dhe në TV, duke organizuar tryeza bashkëbisedimi dhe debati të zhvillimit të simboleve monumentale.

Organizata e Dëshmorëve në bashkëpunim me Bashkinë në 80-vjetorin e çlirimit të Atdheut të nxjerrë një album me veprat artistike më të arrira të simboleve monumentale, fletë palosje të objekteve, broshura për Heronj të Popullit që kanë 80-vjetorin e rënies. Ne mendojmë se përcaktimi konkret i masave për forcimin e mëtejshëm të rolit të simboleve monumentale është i domosdoshëm.

PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Ceremonia në selinë e NATO-s shënoi dy-vjetorin e pushtimit në shkallë të plotë të Ukrainës nga Rusia. Ndërsa NATO dënon luftën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës në termat më të ashpër të mundshëm, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Mircea Geoană theksoi gjatë ceremonisë rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme për Ukrainën. Ai përshëndeti suksesin e Ukrainës në fushën e betejës që nga pushtimi, dhe theksoi angazhimin e vazhdueshëm të NATO-s për vendin.

Teksa kujtoi llojet e ndryshme të mbështetjes së ofruar nga aleatët që nga fillimi i luftës, z. Geoană theksoi se të gjithë aleatët kanë rënë dakord që Ukraina do të bëhet anëtar i NATO-s. “Unë besoj tek Ukraina. Unë besoj në NATO, dhe unë besoj se së bashku ne mund të sigurojmë një të ardhme më të sigurt për të gjithë ne”, - tha ai.

Fjala e tij u pasua nga një moment heshtjeje dhe më pas ambientit u pushtua nga tingujt e himnit kombëtar të Ukrainës, performuar nga Volodymyr Kapshuk, bariton ukrainas aktualisht me Opera National De Paris. Pas performancës, ambasadorët e NATO-s vendosën lulediellin në hartën e Ukrainës.

“NATO do të vazhdojë të qëndrojë me Ukrainën, për sigurinë tuaj, dhe për tonën”

Agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës po minon rëndë sigurinë euroatlantike dhe globale dhe është një shkelje e hapur e ligjit ndërkombëtar. “Sot, ne shënojmë dy vjet që kur tanket ruse u futën në Ukrainë, fillimi i luftës më të madhe në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore”, - tha në hyrje të deklaratës së tij Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s në përvjetorin e dytë të pushtimit të plotë të Ukrainës nga Rusia. “Më lejoni të filloj duke nderuar të gjithë ata ukrainas të guximshëm që kanë rënë ose janë plagosur në mbrojtje të atdheut të tyre. Situata në fushën e betejës mbetet jashtëzakonisht serioze. Qëllimi i Presidentit Putin për të dominuar Ukrainën nuk ka ndryshuar dhe nuk ka indikacione se ai po përgatitet për paqen”, - tha Sekretari i Përgjithshëm.

Ukraina ka demonstruar aftësi të jashtëzakonshme dhe vendosmëri të ashpër përsëri dhe përsëri dhe Ukraina nuk u rrëzua brenda disa javësh, pasi shumë kishin frikë se kjo do të ndodhte.

“Ju keni kapur gjysmën e territorit të kapur nga Rusia. E shtytë Rusinë të kthehej nga pjesë të mëdha të Detit të Zi dhe shkaktuar humbje të mëdha në forcat ruse. Mbi të gjitha, Ukraina ruan lirinë dhe pavarësinë e saj. Kjo është bërë e mundur nga guximi dhe zgjidhja juaj, mundësuar nga mbështetja e madhe ushtarake dhe ekonomike nga aleatët e NATO-s”, - tha Stoltenberg në deklaratën e tij.

Ndërsa në ditët dhe javët e kaluara, aleatët e NATO-s kanë njoftuar pako të reja ndihmëse me vlerë miliarda dollarë që mbulojnë aftësi kryesore si municion artilerie, mbrojtje ajrore dhe anije luftarake, si dhe pajisjet F-16 dhe pjesët rezervë, dronët dhe pajisjet e prishjes.

“Më shumë mbështetje është në rrugën e duhur, - tha Sekretari i Përgjithshëm. - Presidenti Putin e filloi këtë luftë sepse ai donte të mbyllte derën e NATO-s dhe t’i mohojë Ukrainës të drejtën për të zgjedhur rrugën e vet. Por ai ka arritur të kundërtën: Ukraina tani është më afër NATO-s se kurrë më parë. Ne po ndihmojmë për t’i bërë forcat tuaja gjithnjë e më të ndërveprueshme me aleatët. Ne do të hapim së bashku një Qendër të re të Analizës, Trajnimit dhe Edukimit të Përbashkët në Poloni. Dhe ne po thellojmë lidhjet tona politike përmes Këshillit të NATO-Ukrainës, ku ne këshillohemi dhe marrim vendime së bashku”, - tha ai.

“Ukraina do të bashkohet me NATO-n. Nuk është çështje nëse, por kur. Ndërsa ju përgatisim për atë ditë, NATO do të vazhdojë të qëndrojë me Ukrainën, për sigurinë tuaj, dhe për tonën”, - mbylli deklaratën e tij Sekretari i Përgjithshëm.

Ukraina e pavarur dhe demokratike, është jetike për stabilitetin e zonës Euro-Atlantike

Aleatët e NATO-s, në bashkëpunim me rezolutat përkatëse të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, kërkojnë që Rusia të ndalojë menjëherë luftën, të ndërpresë përdorimin e forcës kundër Ukrainës dhe të tërheqë plotësisht dhe pa kushte të gjitha forcat e saj nga Ukraina. Aleatët nuk i njohin, dhe nuk do t’i njohin kurrë aneksimet ilegale dhe të paligjshme të Rusisë, përfshirë Krimenë. Që nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia dhe fillimi i agresionit të saj në Ukrainën lindore në vitin 2014, NATO ka përforcuar mbështetjen e saj për zhvillimin e aftësive dhe ndërtimin e kapaciteteve në Ukrainë, së bashku me trajnimin e aleatëve të dhjetëra-mijëra trupave ukrainase.

Edhe Këshilli i NATO-UKRAINË, duke shënuar dy vjet pushtimin në shkallë të plotë të Rusisë në Ukrainë lëshoi deklarata të tij, ku dënon agresionin e paprecedentë të Rusisë ndaj një kombi sovran.

“Sot ne shënojmë solemnisht dy vjet pushtim brutal në shkallë të plotë të Rusisë në Ukrainë, dhe dhjetë vjet nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia dhe ndërhyrja fillestare ushtarake në Donbas. Burrat dhe gratë e forcave të armatosura të Ukrainës dhe njerëzit e Ukrainës vazhdojnë të frymëzojnë botën me vendosmërinë dhe trimërinë e tyre në mbrojtjen heroike të kombit të tyre, tokën e tyre dhe vlerat tona të përbashkëta. Ne i

E ardhmja e Ukrainës është në NATO



bëjmë nderime jetës së humbur dhe e zhvlerësojmë vuajtjet dhe shkatërrimin tragjik të njeriut të shkaktuar nga lufta e paligjshme e pajustifikueshme dhe e paprovuar e Rusisë. Rusia ka dështuar në përpjekjet e saj për të minuar shtetësinë e Ukrainës dhe për të prishur vendosmërinë e popullit ukrainas. Ukraina ka mbizotëruar si një komb sovran dhe demokratik, duke çliruar territorin e rëndësishëm dhe duke shtyrë përsëri flotën e Detit të Zi të Rusisë”, thuhet në fillim të deklaratës.

Rusia ka përgjegjësi të plotë për këtë luftë dhe të tërheqë plotësisht dhe pa kushte të gjitha forcat e saj ushtarake nga Ukraina në përputhje me rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të KB. Ne nuk i njohim dhe nuk do t’i njohim kurrë aneksimet e paligjshme dhe ilegale të Rusisë, përfshirë Krimenë. Rusia nuk ka treguar ndonjë hapje të mirëfilltë për një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme. Aleatët mirëpresin dhe mbështesin angazhimin e Presidentit Zelenskyy për të përcaktuar parimet për një paqe gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe të qëndrueshme përmes formulës së tij të paqes”.

Aleatët mbeten po aq të vendosur sa kurrë në mbështetjen e Ukrainës për aq kohë sa kërkon që Ukraina të mbizotërojë. “Ne i mirëpresim përpjekjet e të gjithë aleatëve dhe partnerëve që bien dakord për angazhimet dypalëshe afatgjata të sigurisë dhe aranzhimet me Ukrainën. Ndërsa Ukraina ushtron të drejtën e saj të qenësishme për vetëmbrojtje, siç përcaktohet në nenin 51 të Kartës së KB, aleatët dhe partnerët po ofrojnë ndihmë të vazhdueshme ushtarake, financiare dhe humanitare. NATO vazhdon të mbështesë Ukrainën me pajisje dhe pajisje jo-vdekjeprurëse të nevojshme për të forcuar vetëmbrojtjen e Ukrainës. NATO është e përkushtuar të ndihmojë në forcimin dhe rindërtimin e sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes së Ukrainës, të mbështesë pengimin dhe mbrojtjen e Ukrainës në një afat të gjatë, dhe kalimin e Ukrainës në ndërveprimin e plotë me NATO-n”. Puna po vazhdon në rimëkëmbjen dhe reformën afatgjatë, duke përfshirë mbrojtjen e ajrit dhe raketave, rehabilitimin mjekësor për ushtarët e plagosur të Ukrainës, mbështetjen për veteranët, rindërtimin e pas luftës, prokurimin e mbrojtjes dhe forcimin e kapacitetit industrial të mbrojtjes së Ukrainës. Ne gjithashtu kemi rënë dakord të krijojmë një Qendër për Trajnim dhe Edukim të Analizës së Përbashkët të NATO-Ukrainës në Poloni për të identifikuar dhe zbatuar mësimet të marra nga lufta e Rusisë kundër Ukrainës”.

Një Ukrainë e fortë, e pavarur dhe demokratike është jetike për stabilitetin e zonës Euro-Atlantike. Lufta e Ukrainës për pavarësinë e saj, sovranitetin dhe integritetin territorial brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht kontribuon drejtpërdrejt në sigurinë euro-atlantike. Në Këshillin e NATO-Ukrainës, Aleatët dhe Ukraina po punojnë ngushtë dhe marrin vendime së bashku, si të barabarta, për të mbështetur integritetin e mëtejshëm

të Ukrainës me NATO-n, në përputhje me vendimet e Samitit të Vilnius. E ardhmja e Ukrainës është në NATO. Aleatët dhe Ukraina qëndrojnë së bashku.

Aspiratat për anëtarësim në NATO

Në përgjigje të aspiratave të Ukrainës për anëtarësim në NATO, aleatët kanë rënë dakord që në Samitin e Bukureshtit të vitit 2008 që Ukraina të bëhet anëtare e NATO-s. Ata ranë dakord gjithashtu se hapi tjetër i Ukrainës në rrugën e saj drejt anëtarësimit ishte Plani i Veprimit për Anëtarësim (MAP), programi i NATO-s për reformat politike, ekonomike, të mbrojtjes, burimeve, sigurisë dhe ligjore për vendet aspirante. Në vitin 2009, Programi Kombëtar Vjetor u prezantua si instrumenti kryesor i Ukrainës për të çuar përpara integritetin e saj euroatlantik dhe reformat përkatëse. Nga viti 2010 deri në vitin 2014, Ukraina ndoqi një politikë mos angazhimi, të cilën e ndërpreu si përgjigje ndaj agresionit të Rusisë.

Që nga Samiti i NATO-s në Varshavë në korrik 2016, mbështetja praktike e NATO-s për Ukrainën është përcaktuar në Paketën Gjithëpërfshirëse të Ndihmës (CAP) për Ukrainën. E në qershor 2017, Parlamenti ukrainas miratoi legjislacionin që rivendos anëtarësimin në NATO si një objektiv strategjik të politikës së jashtme dhe të sigurisë. Kurse në vitin 2019, hyri në fuqi amendamenti përkatës i Kushtetutës së Ukrainës. Në shtator të vitit 2020, Presidenti Volodymyr Zelenskyy miratoi Strategjinë e re të Sigurisë Kombëtare të Ukrainës, e cila parashikon zhvillimin e partneritetit të veçantë me NATO-n me qëllim anëtarësimin në NATO. Në shtator 2022, pas aneksimave të paligjshme të Rusisë të territorit ukrainas, Ukraina përsëriti kërkesën e saj për anëtarësim në NATO.

Ndërsa në Samitin e Madridit 2022, aleatët forcuan CAP për të ofruar edhe më shumë mbështetje për Ukrainën. Më pas në Samitin e Vilniusit të vitit 2023, aleatët ranë dakord të zhvillojnë më tej CAP në një program shumëvjeçar ndihme, për të ndihmuar në rindërtimin e sektorit të sigurisë dhe mbrojtjes të Ukrainës dhe tranzicionin e Ukrainës drejt ndërveprimit të plotë me NATO-n.

NATO qëndron në solidaritet të palëkundur me qeverinë dhe popullin e Ukrainës në mbrojtjen heroike të kombit të tyre, tokës së tyre dhe vlerave tona të përbashkëta. Aleanca mbështet plotësisht të drejtën e natyrshme të Ukrainës për vetëmbrojtje, siç parashikohet në nenin 51 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Në Samitin e Vilniusit të vitit 2023, aleatët gjithashtu rikonfirmuan angazhimin e tyre se Ukraina do të bëhet anëtare e NATO-s. Duke njohur ndërveprueshmërinë në rritje të Ukrainës dhe përparimin thelbësor me reformat, ata vendosën se rruga e Ukrainës drejt integritetit të plotë euroatlantik ka shkuar përtej nevojës për Planin e Veprimit të Anëtarësimit. Aleatët do të vazhdojnë të mbështesin dhe rishikojnë përparimin e Ukrainës në ndërveprim, si dhe reformat shtesë të sektorit demokratik dhe të sigurisë që kërkohen në rrugën e saj drejt anëtarësimit të ardhshëm. Ministrat e Jashtëm të NATO-s vlerësojnë rregullisht progresin përmes Programit Kombëtar Vjetor të përshtatur. “NATO do të jetë në gjendje t’i japë një ftesë Ukrainës për t’u bashkuar me Aleancën kur Aleatët të bien dakord dhe të plotësohen kushtet”. Bashkëpunimi është thelluar me kalimin e kohës dhe është reciprokisht i dobishëm. Ukraina ka një histori të gjatë të kontributeve aktive në operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO.

Kromozomi Y po zhduket. Ja çfarë do të thotë për meshkujt

Përcaktimi i gjinisë në lindje vendoset në kromozomet që ka foshnja. Një femër ka dy kromozome X, ndërsa një mashkull ka një kromozom X dhe një Y.

Sipas “Medline Plus”, në çdo qelizë, njerëzit zotërojnë 23 palë kromozome, ndër të cilat kromozomet e gjinisë përbëjnë një palë. Kromozomi X, që përfshin afërsisht 155 milionë çifte bazash të ADN-së, përbën rreth 5% të ADN-së totale në qeliza.

Kromozomi Y shtrihet mbi më shumë se 59 milionë blloqe ndërtimi të ADN-së (çifte bazash) dhe përbën gati 2% të ADN-së totale të gjetur në qeliza.

Megjithatë, sipas “The Conversation”, kromozomi Y po degradon me një shpejtësi shqetësuese.

Çfarë po ndodh me kromozomin Y?

Janë vërejtur se ka pasur shumë ndryshime në kromozomin Y gjatë viteve.

Kromozomet tona të gjinisë ishin fillimisht një palë kromozome tipike XY, një tipar i vërejtur ende te zogjtë dhe zvarranikët. Edhe te gjitarët e metronomit, si platipuset dhe ekidnat, kromozomet XY janë të zakonshëm.

Brenda 166 milionë viteve të fundit, kromozomi Y i njeriut ka humbur shumicën e 1600 gjeneve të tij me një normë prej gati 10 për milion vjet. Me këtë ritëm, kromozomi Y pritët të zhduket në rreth 4.5 milionë vjet.

Kjo nuk është e papritur, sipas “The Conversation”. Është e zakonshme që kromozomet seksuale të prishen me kalimin e kohës. “Përvetësimi i një gjeni që përcakton gjininë është puthja e vdekjes për një kromozom, sepse gjenet e tjera pranë Y evoluojnë një funksion specifik për mashkullin dhe këto gjene mbahen së bashku duke shtypur shkëmbimin me X.”

Kjo do të thotë se kromozomi Y nuk mund të zëvendësojë ADN-në e keqe me kromozomin X, duke e bërë të vështirë eliminimin e mutacioneve, fshirjeve ose ADN-së së keqe.

“Kromozomi Y i varfër është gjithashtu në disavantazh. Ky është një vend i rrezikshëm sepse qelizat duhet të ndahen shumë herë për të krijuar spermë, kështu që mutacionet janë shumë më të shpeshta”.

Çfarë ka ndodhur me kromozomet Y të kafshëve?

Disa lloje të molave në Evropën Lindore dhe minjtë me gjemba në Japoni kanë dëshmuar zhdukjen e plotë të kromozomit Y dhe gjenit SRY, i cili ndihmon në përcaktimin e gjinisë mashkullore në popullata të caktuara të kafshëve. Në këto specie, kromozomi X mbetet, duke ekzistuar ose në një dozë të vetme ose të dyfishtë, si te meshkujt ashtu edhe te femrat, sipas “Science Alert”.

Në një studim të publikuar nga PNAS, biologja e Universitetit “Hokkaido, Asato Kuroiwa” dhe ekipi i saj zbuluan se shumica e gjeneve fillimisht në kromozomin Y të minjve me gjemba janë zhvendosur në kromozome të tjera. Megjithatë, ata kishin vështirësi në gjetjen e gjenit SRY.

Në vitin 2022, ata identifikuan me sukses sekuencat e ADN-së të pranishme te minjtë meshkuj dhe jo te femrat. Pasi studiuan nga afër sekuencat, ata zbuluan gjithashtu një ndryshim të vogël pranë gjenit të quajtur SOX9. Ky gjen i tregon trupit se si të bëjë një proteinë të rëndësishme për zhvillimin e testikujve, sipas studimit.

Shkencëtarët besojnë se kjo pjesë shtesë e ADN-së është si një çelës që ndez SOX9, edhe pa gjenin SRY. Për të testuar idenë e tyre, ata vendosën këtë ADN shtesë te minjtë dhe zbuluan se kjo e bëri SOX9 të funksiononte më mirë.

Kjo do të thotë se edhe pa SRY, SOX9 ende mund të bëjë punën e tij, falë kësaj pjesë të vogël të ADN-së shtesë, sipas studimit.

A ka shpresë?

“The Conversation” vëren se ekipi i biologut David Page nga Bostoni janë avokatë të fortë të qëndrueshmërisë së kromozomit Y.



Ata theksojnë se ndërsa shimpanzetë kanë humbur disa gjene që kur njerëzit dhe shimpanzetë kishin një paraardhës të përbashkët 5 milionë vjet më parë, njerëzit nuk kanë përjetuar humbje të konsiderueshme të gjeneve. Në fakt, gjatë 25 milionë viteve që kur njerëzit u ndanë nga majmunët, njerëzit kanë humbur shumë pak gjene.

“Ka gjene në kromozomin Y që janë aktivë në çdo cep të trupit. Lëkura, gjaku, truri, mushkëritë - me pak fjalë, kudo. Ata duken të jenë një lloj sipërmarrësi global brenda gjenomit njerëzor. Ata janë një lloj rregullatori kryesor.

Megjithatë, Jennifer Graves, një gjenetiste nga Universiteti “La Trobe” tha “Unë nuk mendoj se mund të supozohet se vetëm sepse ata janë atje dhe bëjnë diçka të dobishme, ata do të jenë atje përgjithmonë. Një aksident i vogël mund ta përmbysë atë, ose evolucioni i një sistemi të ri për përcaktimin e gjinisë që funksionon më mirë”.

Nëse kromozomi Y ndryshon, a do të ketë më pak sëmundje te meshkujt?

Jan Dumanski, nga Universiteti “Uppsala” në Suedi,

thotë se mund të ketë një lidhje midis kromozomit Y dhe kancerit.

“Kjo po na bën burra, por gjithashtu na shkakton disa telashe kur po plakemi”, - tha ai.

Megjithatë, një rishikim, i publikuar nga Biblioteka Kombëtare e Mjekësisë, zbuloi se humbja e kromozomit Y mund të krijojë gjithashtu një rrezik në rritje të zhvillimit të sëmundjes së Alzheimerit, kancerit dhe sëmundjeve kardiovaskulare.

Po sikur të mos stabilizohet?

Ndërsa riprodhimi aktualisht do të ishte i vështirë nëse nuk do të kishte më burra, siç vë në dukje “The Conversation”, 4.5 milionë vjet është një kohë e gjatë. Meqenëse ne jemi njohur si njerëz për më pak se 100,000 vjet, nuk ka nevojë të shqetësohemi.

Për më tepër, ka shumë skenarë të mundshëm në të cilët speciet tona ka të ngjarë të përballen me zhdukjen shumë kohë përpara se kromozomi Y të zhduket.

"Rezultati mund të jetë zhdukja"

Studiuesi i mbështetur nga Elon Musk paralajmëron se nuk ka asnjë provë që AI-ja mund të kontrollohet dhe thotë se teknologjia duhet të frenohet TANI

Një studiues i mbështetur nga Elon Musk po ringre alarmin për kërcënimin e AI-së për njerëzimin, pasi nuk ka gjetur asnjë provë se teknologjia mund të kontrollohet.

Dr. Roman V. Yampolskiy, një ekspert i sigurisë së AI-së, ka marrë fonde nga miliardi për të studiuar sisteme të avancuara inteligjente që janë fokusi i librit të tij të ardhshëm "AI: E pashpjegueshme, e papashikueshme, e pakontrollueshme".

Libri shqyrton se si AI-ja ka potencialin për të riformuar në mënyrë dramatike shoqërinë, jo gjithmonë në avantazhin tonë, dhe ka "potencialin për të shkaktuar një katastrofë ekzistenciale".

Yampolskiy, i cili është një profesor i asociuar i shkencave kompjuterike në Universitetin e Louisville, kreu një ekzaminim të literaturës shkencore mbi AI-në dhe arriti në përfundimin se nuk kishte asnjë provë që teknologjia mund të ndalohej të bëhej mashtruese.

Për të kontrolluar plotësisht AI-në, ai sugjeroi që ajo duhet të jetë e modifikueshme me opsione "zhbëj", e kufizuar, transparente dhe e lehtë për t'u kuptuar në gjuhën njerëzore.

"Nuk është çudi që shumë e konsiderojnë këtë si problemin më të rëndësishëm me të cilin është përballur ndonjëherë njerëzimi", - u shpreh Yampolskiy në një deklaratë.

"Rezultati mund të jetë prosperitet ose zhdukje, dhe fati i universit varet në balancë".

Shefi ekzekutiv i "OpenAI", Sam Altman tha se pyetjet dhe shqetësimet rreth AI-së janë të rëndësishme, por ndoshta jo jeta si rezultat i rebelimit të robotëve kundër njerëzimit.

"Ka disa gjëra që janë të lehta për t'u imagjinuar se deri ku gjërat shkojnë vërtet keq. Unë jam shumë më i interesuar për mospërputhjet shumë delikate shoqërore, ku ne thjesht i kemi këto sisteme në shoqëri, dhe për shkak të asnjë qëllimi të keq të veçantë, gjërat shkojnë tmerrësisht keq".

Musk raportohet të ketë siguruar financime për Yampolskiy në të kaluarën, por shuma dhe detajet nuk dihen.

CEO i "Tesla-s" gjithashtu ka dhënë alarmin për AI-në, veçanërisht në vitin 2023 kur ai dhe më shumë se 33 000 ekspertë të industrisë nënshkruan një letër të hapur për "Future of Life Institute" (Institutin e Ardhmërisë së Jetës).

Letra shpreh se laboratorët e AI-së janë aktualisht 'të bllokuar në një garë jashtë kontrollit për të zhvilluar dhe vendosur mendje dixhitale gjithnjë e më të fuqishme që askush - madje as krijuesit e tyre - nuk mund t'i kuptojë, parashikojë ose kontrollojë në mënyrë të besueshme. Sistemet e fuqishme të AI-së duhet të zhvillohen vetëm pasi të kemi besim se efektet e tyre do të jenë pozitive dhe rreziqet e tyre do të jenë të menaxhueshme".

Musk ka shprehur dëshirën për të siguruar që AI-ja dhe robotët e kompanive të tij të mund të menaxhohen nga njerëz, duke përfshirë bërjen e robotit "Tesla" 'Optimus' aq të dobët sa të mos mund të dëmtojë njerëzit.

"Ne po e vendosim atë në mënyrë që të jetë në një nivel mekanik, në një nivel fizik, që ju të mund të ikni prej tij dhe ka shumë të



ngjarë ta mposhtni atë", - tha ai ndërsa shpalli "Optimus" në 2021.

Dhe libri i ardhshëm i Yampolskiy duket se i bën jehonë shqetësimeve të tilla. Ai ngriti shqetësime rreth mjeteve të reja që po zhvillohen në vitet e fundit që paraqesin rreziqe për njerëzimin, pavarësisht nga përfitimet që ofrojnë modele të tilla.

Vitet e fundit, bota ka dëshmuar se AI-ja filloi me gjenerimin e pyetjeve, kompozimin e e-maileve dhe shkrimin e kodit.

Tani, sisteme të tilla po zbulojnë kancerin, po krijojnë ilaçe të reja dhe po përdoren për të kërkuar dhe sulmuar objektivat në fushën e betejës.

Dhe ekspertët kanë parashikuar që teknologjia do të arrijë singularitetin deri në vitin 2045, që është kur teknologjia tejkalon inteligjencën njerëzore dhe ka aftësinë për të riprodhuar veten, në atë moment ne mund të mos jemi në gjendje ta kontrollojmë atë.

"Pse kaq shumë studiues supozojnë se problemi i kontrollit të AI-së është i zgjidhshëm", - tha Yampolskiy.

"Me sa dimë, nuk ka asnjë provë për këtë, asnjë provë. Përpara se të filloni një kërkim për të ndërtuar një AI të kontrolluar, është e rëndësishme të tregoni se problemi është i zgjidhshëm".

Ndërsa studiuesi tha se ai kreu një përmbledhje të gjerë për të arritur në përfundimin, saktësisht se çfarë literaturë është përdorur nuk dihet në këtë pikë.

Ajo që bëri Yampolskiy dha arsytimin e tij se pse ai beson se AI-ja nuk mund të kontrollohet - teknologjia mund të mësojë, përshtatet dhe të veprojë në mënyrë gjysmë autonome.

Aftësi të tilla i bëjnë aftësitë vendimmarrëse të pafundme, dhe kjo do të thotë se ka një numër të pafund çështjesh sigurie që mund të lindin, shpjegoi ai.


Dhe për shkak se teknologjia përshtatet me kalimin e kohës, njerëzit mund të mos jenë në gjendje të parashikojnë problemet.

"Nëse nuk i kuptojmë vendimet e AI-së dhe kemi vetëm një 'kuti të zezë', nuk mund ta kuptojmë problemin dhe të zvogëlojmë gjasat e

aksidenteve të ardhshme", - tha Yampolskiy.

"Për shembull, sistemet e AI-së, tashmë janë duke u ngarkuar me marrjen e vendimeve në kujdesin shëndetësor, investimet, punësimin, bankat dhe sigurinë, për të përmendur disa".

Sisteme të tilla duhet të jenë në gjendje të shpjegojnë se si arriten në vendimet e tyre, veçanërisht për të treguar se janë pa paragjykim.



"Nëse mësohemi të pranojmë përgjigjet e AI-së pa shpjegim, duke e trajtuar në thelb si një sistem Oracle, nuk do të jemi në gjendje të dallojmë nëse ai fillon të japë përgjigje të gabuara ose manipuluese", - shpjegoi Yampolskiy.

Ai gjithashtu vuri në dukje se ndërsa aftësia e AI-së rritet, autonomia e saj gjithashtu rritet, por kontrolli ynë mbi të zvogëlohet - dhe rritja e autonomisë është sinonim i uljes së sigurisë.

"Njerëzimi po përballlet me një zgjedhje: të bëhemi si foshnjat, që të kujdesen për ne, por të na kenë në kontroll apo të refuzojmë të kemi një kujdestar të dobishëm, por të mbetemi përgjegjës dhe të lirë", paralajmëroi Yampolskiy.

Eksperti ndau sugjerime se si të zbuten rreziqet, të tilla si dizenjimi i një makinerie që ndjek saktësisht urdhrat e njeriut, por Yampolskiy vuri në dukje potencialin për urdhra konfliktuale, keqinterpretim ose përdorim me qëllim të keq.

"Njerëzit nën kontroll mund të rezultojnë në urdhra kontradiktore ose në mënyrë eksplicite keqdashëse, ndërsa AI-ja në kontroll do të thotë që njerëzit nuk janë", shpjegoi ai.

"Shumica e studiuesve të sigurisë së AI-së janë duke kërkuar një mënyrë për të lidhur superinteligjencën e ardhshme me vlerat e njerëzimit. Inteligenca artificiale e përafuar me vlerë do të jetë e njëanshme sipas definicionit, paragjykimi pro-njerëzor, i mirë apo i keq është ende një paragjykim.

Paradoksi i inteligjencës artificiale të përafuar me vlera është se një person që urdhëron në mënyrë eksplicite një sistem AI për të bërë diçka, mund të marrë një "jo" ndërsa sistemi përpiqet të bëjë atë që personi në të vërtetë dëshiron. Njerëzimi ose mbrohet ose respektohet, por jo të dyja".



Maro Kondi, portreti i labes së rrallë

Me dështimin e Kryengritjes së Tanzimatit, në verën e vitit 1847, udhëheqësit e kryengritjes Zenel Gjoleka me luftëtarë të tjerë u strehuan në një shpellë në malin Çorraj. Maro Kondi, vajza, komandantja trime, u kap nga ushtarët osmanë, kur kishte zbritur për të marrë ujë. Pushtuesit i kërkuan t’u tregonte ku fshiheshin luftëtarët e lirisë, dhe me të mirë dhe me kërbaç i kërkuan t’i çonte atje ku strehoheshin prijësit e kryengritjes, te shkëmbi i Kadafiqit. Ajo i kaloi në një rrugë të vështirë. Kur iu afrua shpellës, u hodh në një humnerë prej 150 m, duke tërhequr edhe ushtarët turq që e ndiqnin të lidhur me litar. Thuhet se pashai turk kur mësoi për këto humbje, veç atyre që mundi të kapë e t’i pushkatonte, bëri dhe këtë mallkim: “U shfarostë ky millet qafir”. Poshtë Kadafiqit, në këmbët e Malit të Harapës, te Guri i Gjatë, për nder të saj është ngritur lapidar.

Në radhët e trimëreshave shqiptare të shekullit të kaluar, vend nderi zë dhe bija guximtare e Labërisë, Maro (Mete) Kondi. Maroja, trime dhe komandante popullore, njihej me emrin Mete, e lindur në fshatin malor Çorraj të Kurveleshit, në vitin 1820, në familjen Kondi, në lagjen Gjihilaj dhe u martua në fisin Kolekaj. Mjaft bashkëfshatarë dhe të afërt të saj ishin luftëtarë, si Duke Kondi, Malo Duka, Foto Kopali etj. Fillimisht bënë pjesë në ushtrinë e Ali pashë Tepelenës. Më pas, me rënien e pashallëkut të Janinës u bashkuan me krerë të Labërisë dhe të Bregdetit, u treguan vazhdimisht trimëri dhe zhvilluan luftime kundër ushtrisë osmane.

Maro Kondi u rrit dhe u edukua në këtë mjedis të flaktë patriotik. Në mjaft raste, Maro kishte parë shtëpi dhe të mbjella të fshatit të djegura nga pushtuesi. Të afërmit e saj ishin rrahur barbarisht nga kamxhiku i osmanlinjve, të lidhur me zinxhirë mbas kuajve të pushtuesit se nuk pranonin në vendin e tyre reformat skllavëruese, se nuk donin që vendi të qeverisej nga të huajt dhe as të paguanin taksa dhe të shkonin ushtarë për Turqinë.

Maro shumë herë ishte udhërrëfyese për luftëtarët e krahinës, organizatore e grupit të grave në prapavija.

Bazuar në përvojën dhe kryengritjet e mëparshme, të cilat për vite me radhë nuk kishin pushuar, edhe në kryengritjen fshatare të vitit 1847, luftëtarët e Çorrajit u ngritën më këmbë. Ata u betuan për të luftuar kundër pushtuesit osman, për jetë a vdekje. Edhe gratë e Çorrajve, e njihnin me pëllëmbë malin e Çorrajit, me gjithë qafat, shtigjet, shpellat e burimet zonës. Vendi ishte tepër i thepisur, por Maroja e kishte mësuar çdo skutë të tij që kur ishte e vogël, duke kullotur dhinë e duke prerë drutë për dimrin e ashpër të kësaj krahine. Shpella e Karanit gjendet pranë fshatit Çorraj. Aty gjendet dhe shkëmbi i Kadafiqit. Ajo kishte një lartësi prej 1-2 m dhe gjatësi rreth 50 m. Në hyrje të saj ka një shesh të vogël. Rruga për të shkuar në shpellë është shumë e vështirë. Gjatë luftës me pushtuesit osmanë këtu u strehua Zenel Gjoleka, kapedan Foto Kopali, si dhe vetë banorët e fshatit.

Ndërsa shkëmbi i Kadafiqit në fshatin Çorraj është shumë pranë shpellës së Karanit. Ky shkëmb u bë i njohur nga akti heroik i Maro Kondit në vitin 1847, e cila, për të shpëtuar Zenel Gjolekën me shokë që strehoheshin në shpellë, u hodh në humnerë nga lartësia 150 m, duke marrë me vete dhe ushtarët osmanë që e shoqëronin. Kënga thotë: “Kadafiqi shtigje-shtigje, ...Nxore nëntëdhjetë vigje”. Maro ka qenë shumë aktive dhe në kryengritjen fshatare të vitit 1847. Me përfundimin e kryengritjes së vitit 1847, ekspedita ndëshkimore osmane i ndoqi kudo luftëtarët shqiptarë. Pjesa më e madhe e luftëtarëve u strehuan gjatë vitit 1847 në malet e larta dhe të thepësura të Labërisë. Trimëreshën Maro Kondi, me mjaft bashkëfshatare të tjera, e gjejmë me luftëtarët e Çorrajit në malin e fshatit. Të gjitha kujdeseshin për strehimin e luftëtarëve kryengritës. Trimi dhe luftëtari i dëgjuar i Labërisë, Zenel Gjoleka, kishte gjetur strehim në këto male. Ai bashkë me luftëtarët kryengritës ishte strehuar në shpellën e Karanit, në Harapë. Kujdes i veçantë u tregua për të nga njerëzit e Maros, siç ishte trimi Malo Duka. Ky luftëtar dhe bujar, për mikpritjen e tij ishte i njohur në të gjithë krahinën dhe njihej me emrin “Malo Buka”.

Komanda osmane e kishte pikasur këtë strehim. Ajo kishte marrë masa dhe ishte nisur me repartet ndëshkuese nga në dy drejtime. Njeri drejtim përshkonte rrugën nga Borshi i Vjetër, për në shpellë dhe tjetri nga Rrëza e Vake, përsëri për në shpellë. Luftëtarët e Çorrajit, duke studiuar situatën morën masa dhe shpërngulën gjithë



fshatit me pleq e fëmijë, duke e siguruar në mal, në Harapë. Luftëtarët e çetës u vendosën në pozicione luftimi. Ata zunë të gjitha shtigjet e vështira për kalim nga lumi deri në Katafigj. Lufta ishte e ashpër nga të dy palët. Luftëtarët e çetës së Çorrajit, nuk i pushuan luftimet, ata përbuzën propozimin e pashait turk, se luftëtarët shqiptarë do të ishin të lirë, vetëm t’i lihej e lirë rruga, kolonës ushtarake osmane për të shkuar në Harapë.

Pashai turk, në këto rrethana dhe në pamundësi për të kaluar në Harapë nga grykat ku ishin vendosur luftëtarët shqiptarë, sugjeroi që me dredhi të gjente tjetër rrugë-kalimi. Ai urdhëroi dhe zuri të gjitha rrugët dhe vendburimet nga furnizohej mali me ujë. Qëllimi për të shtrënguar trimat që të dorëzoheshin nga etja. Kjo pengesë u kalua nga kryengritësit. Gratë e fshatit gjetën rrugë të tjera dhe furnizuan me ujë luftëtarët, pa u diktuar nga ushtarët osmanë.

Akti heroik i luftëtares Maro

Ushtarët osmanë, pasdite vonë mundën të kapin në befasi, duke mbushur ujë, bijën luftëtare të fshatit Çorraj, trimëreshën Maro Kondi. Ajo kishte zbritur fshehtas nga mali për të mbushur ujë për luftëtarët, por ishte ndjekur nga ushtarët osmanë.

Fillimisht luftëtaren e morën me të mirë, për t’u treguar shtigjet e kalimit për në mal. Më pas kur nuk tregoi, filluan ta torturonin gruan luftëtare. Ata e detyruan të ecte në gjurmët e saj, andej nga kishte ardhur. Shtegu për në vendstrehim, për në Katafigj, ishte thiktë dhe i rrezikshëm. Pakujdesia më e vogël të hidhte në humnerë pa asnjë shpresë shpëtimi.

Ushtarët turq ecnin këmba-doras të lidhur me litarë njëri mbas tjetrit. Ata shikonin të tmerruar humnerën, honin e pafund që shtrihet poshtë këmbëve të tyre, disa qindra metra thellë. Maro Kondi, megjithëse dhe etorturuar, me fëmijën në duar ecte e qetë në krye të ushtarëve armiq.

Siç përshkruhet në librin “Trima të kryengritjeve popullore”, luftëtarja Maro Kondi kur arriti në kthesën e fundit, në një vend

shumë të rrezikshëm, ku ushtarët osmanlinj duhet të kalonin për një, mendoi të hidhej nga shkëmbi si rruga e vetme për të mos dorëzuar kryengritësit te armiku. Aty duhej të ecje ngjitur dhe duke u mbajtur pas shkëmbinjve të thepisur. Këtu u kthye mbrapsht me rrëmbim dhe hodhi në humnerë ushtarin e parë osman që vinte pas saj. Ai duke qenë i lidhur me të tjerët, i mori me vete në humnerë. Britmat e ushtarëve osmanlinj u dëgjuan në mbarë vendin.

Luftëtarët shqiptarë që vrojtonin lëvizjen e kolonës armike, i qenë afruar grykës, ndërsa ushtarët osmanë, që i shpëtuan grackës, u vërsulën mbi këtë bijë shqiptare. Ajo tërhoqi pas vetes dhe një nga ushtarët që e kishte mbërthyer, dhe u hodh në humnerë bashkë me fëmijën e saj. Luftëtarët çorrotë të zemëruar nga humbja e kësaj trimëreshë, vunë në përdorim shkëmbinjtë e gurët. Kështu u mbyllën shtegun e kalimit osmanëve të mbetur në qafë të malit. Të gjithë ushtarët osmanë përfunduan në fund të humnerë.

Sakrificat e luftëtarëve dhe banorëve të fshatit Çorraj janë përjetësuar në vargjet popullore: “...Katafigji portë-portë,/ Shove gorogoriciotë...”. Rreth nëntëdhjetë ushtarë e oficerë turq u gjendën të copëtuar nëpër shkëmbinjtë e Katafigjit. Kënga popullore thotë: “...Katafigji shtigje-shtigje,/ Nxore nëntëdhjetë vigje...”. Ushtarët osmanë u mbartën nga autoritetet osmane dhe u varrosën në Delvinë. Ndërsa Maro luftëtarja, e copëtuar, së bashku me fëmijën e saj u varros me nderime të mëdha nga luftëtarët shqiptarë, poshtë Katafigjit, në rrëzë të Harapës, te Guri i Gjatë.

Për figurën e Maro Kondit është shkruar gjerësisht në librin “Dëshmorët e Atdheut”, të botuar në vitin 2012, nën kujdesin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Maro Kondi, me vendim nr. 116, datë 6 nëntor 1984, të Komitetit Ekzekutiv të rrethit të Sarandës, është shpallur dëshmore dhe ndodhet në varrezat e Dëshmorëve të Sarandës.

Kjo është dëshmorja e parë e Atdheut për nga largësia e viteve, e shpallur në bazë të ligjeve të shtetit shqiptar.

Fjalime të mbajtura gjatë Luftës së Dytë Botërore e pas saj, 1940-1946

Nga të gjitha figurat politike britanike të shekullit të XX, Winston Churchill spikati si oratori më i shquar. Në njëfarë mase, jehona e fjalimeve të tij të Luftës së Dytë Botërore është një pasqyrim i kohëve të turbullta në të cilën ato u mbajtën. Por përveç kësaj, historia u ka dhënë atyre fjalimeve një rol qendror në qëndresën e përpjekjeve të luftës së Britanisë, në mënyrë të veçantë gjatë viteve 1940-1941, kur një vend relativisht i cenushtëm i bëri ballë i vetëm makinës së fuqishme ushtarake gjermane.

Churchill merrte shkas nga ngjarjet e luftës, shpesh dëshpëruese në vetvete, dhe i interpretonte ato në mënyrë të atillë, që fatkeqësinë dhe dëshpërimin ta kthente në vetëbesim, në shpërfillje të rrezikut e në vendosmëri të patundur. Duke theksuar, nganjëherë dhe me të tepërt, atë që në lojë, ai e paraqiste luftën e Perandorisë së tij Britanike, si një pjesë të dramës së përbotshme për shpëtimin e qytetërimit. Në gjithë këtë kishte diçka mesianike, tek i ledhatonte dhe i fuqizonte dëgjuesit e tij, duke i bërë të besonin se lufta kundër Gjermanisë naziste ishte një betejë që ia vlente të luftohej dhe një betejë që ata mund ta fitonin.

Në ditët e hershme të karrierës së tij, Churchill ndihej inferior ndaj shumë prej shokëve të vet, ngaqë nuk kishte ndjekur arsimimin universitar. Atij i vinte keq për mungesën e praktikës në të folurit publik, gjë që do ta kishte fituar në debatet universitare.

Ai gjithashtu vuante nga një ‘thuthuqe’ e lehtë e nga njëfarë belbëzimi. Kjo ishte arsyeja përse atij iu bë zakon t’i përgatiste me shkrim fjalimet, në mënyrë që të shmangte modelat e fjalimeve të përditshme pa letër.

WINSTON CHURCHILL

Lindi më 30 nëntor 1874, në Blenheim Palace, Oxfordshire, Angli. Djali më i madh i lord Randolph Churchill dhe Jennie Jerome (vajza e një manjati amerikan). I arsimuar në Harrow School / Royal, Military Academy, Sandhurst.

Shërbeu në kabinetin e luftës të Camberlenit, në shtator të vitit 1939, si Lord i Parë i Admirialtit, përpara se ta zëvendësonte atë si kryeministër, dhe korrespondent lufte, duke qenë se me fjalimet e tij, ai krijoi një frymë sfiduese.

I pranishëm në Betejën e Omdurman-it (1897) ndaj rrezikut, ai punoi shumë dhe në luftën kundër Boerëve në një aleancë transatlantike. U zgjodh në Parlament si deputet dhe në maj të vitit 1940, krijoi një qeveri të re koalicioni, si një udhëheqës i shquar i dorës së fortë dhe tepër energjik i kohës së luftës.

Konservator më 1900, kurse më 1904 kaloi me Partinë Liberale qeverisëse, ku u ngrit në detyrën e Sekretarit të Brendshëm më 1910, dhe më pas u bë Lord i Parë i Admirialtit, më 1911. Në vitin 1915 ai mori përgjegjësinë për dështimin e fushatës ushtarake kundër turqve në Galipoli (Dardanele) dhe e la politikën për Frontin e Perëndimit, përpara se të kthehej prapë si ministër i rezervave ushtarake (1917). Shërbeu si Sekretar për Luftën dhe Aviacionin (1919-21) e pastaj, duke mbështetur Konservatorët, si ministër i thesarit (1924-29), pa ndonjë sukses.

Pas pothuajse një dekade largimi nga udhëheqja në vitin 1941, kur u rikthye paqja, pasi Partia Laburiste fitoi zgjedhjet më 1945, ai u bë udhëheqës i opozitës. Mbajti shumë fjalime në mbështetje të Kombeve të Bashkuara dhe paralajmëroi Luftën e Ftohtë dhe kërcënimin bërthamor.

Në vitin 1953, u rikthye në krye të qeverisë, mori titullin e kalorësit në vitin 1953, dhe u tërhoq nga jeta politike më 1955. “Anglezi më i madh i gjallë”, siç u bë i njohur, u argëtua më pas me punën e muratorit, me pikturimin e peizazheve, me shkrime historike dhe duke pirë sa munda shampanjë.

Ai u vizitua tek terapistët e të folurit, duke i praktikuar gjestet përpara pasqyrës. Nganjëherë atij iu deshën javë të tëra për të realizuar fjalimet me stil të rrallë. Fjalori i tij ishte tepër i gjerë, i mbushur me lojëra fjalësh me aliteracione, plot me figura e metafora të gjalla.

Stili i tij nuk përputhej gjithmonë me gjendjen shpirtërore të kohës. Fjalimet e tij u panë me skepticizëm në Dhomën e Komunave, ku ai u zgjodh për herë të parë më 1900.

Gjatë viteve 1930, apo “viteve të shkreta” të tij, ai s’qe veç një deputet i thjeshtë, ai dha mjaft shpesh mesazhe apokaliptike, as politikanët e as vetë publiku s’ua vunë veshin shumë. Por bindja e tij tek Gjermania Naziste - që ajo ishte një ekspansioniste e pangopur, doli se ishte krejtësisht e bazuar. Kur Britania i shpalli luftë Gjermanisë, në shtator të 1939, Çurçilli u thirr të bënte pjesë në qeveri. Më 10 maj 1940, në kohën që forcat gjermane po pushtonin

WINSTON CHURCHILL: Unë nuk kam asgjë tjetër për të ofruar, veç mund, djersë, gjak e lot



Vendet e Ulëta, besimi te kryeministri Çamberlen kishte marrë fund dhe kishte ardhur koha e Çurçillit. Qe pikërisht Çamberleni ai që ia rekomandoi Çurçillin, mbretit Xhorxh VI, që e ndjeu sikur “e tërë jeta e tij kishte kaluar veç një përgatitje për këtë orë”. Më 13 maj, ai i shpjegoi Dhomës së Komunave se çfarë kishte për t’i ofruar vendit të tij.

Atij iu dha misioni për të formuar një qeveri të re. Do të ishte vullneti i qartë i Parlamentit dhe i mbarë kombit që kjo duhet të krijohet me bazën më të gjerë të mundshme dhe të përfshijë të gjitha partitë. Ai tashmë e ka përfunduar pjesën më të rëndësishme të kësaj detyre.

Ftoi ‘Dhomën’ të vendosë për miratimin e këtyre hapave të ndërmarrë dhe t’i deklarojë besimin e saj qeverisë së re. Dhe ky vendim është që: “Kjo Dhomë e mirëpret formimin e një qeverie përfaqësuese të Vendosmërisë së përbashkët e të patundur të mbarë kombit për të vijuar luftën me Gjermaninë deri në fitoren përfundimtare.

“Unë nuk kam asgjë tjetër për të ofruar, veç mund e djersë, gjak e lot”, - u shpreh Çurçilli.

Më tej në retorikën e tij ai theksoi se: “Të formosh një administratë me këto përmasa e kaq të ndërlikur, është në vetvete një sipërmarrje serioze. Por ne jemi në fazën paraprake të njëjës prej betejave më të mëdha të historisë. Ne jemi në veprim edhe në shumë vende të tjera, në Norvegji e në Holandë, dhe na duhet të jemi të përgatitur në Mesdhe. Beteja ajrore është duke vijuar dhe na duhet të bëjmë shumë përgatitje këtu në Atdhe.

Në këtë krizë, unë mendoj se mund të më falet nëse sot nuk zgjatet dhe aq përpara Dhomës dhe shpresoj që secili nga miqtë dhe kolegët, apo kolegët e mi të mëparshëm që janë prekur nga ky rindërtim politik, do të ma lejojnë çdo mungesë ceremonie me të cilën ka qenë e nevojshme të veprohet.

Unë po i them Dhomës, sikurse u kam thënë dhe ministrave që u bënë pjesë e kësaj qeverie, se nuk kam asgjë tjetër për të ofruar ‘veç mund e djersë, gjak e lot’. Ne kemi përpara nesh një provë nga më të rëndat. Ne kemi përpara nesh shumë e shumë muaj lufte dhe vuajtjeje.

Ju do pyesni, po cila është politika jonë? Dhe unë them se ajo është të luftojmë në tokë, në det e në ajër. Luftë me të gjithë fuqinë e me të gjithë forcën që na ka dhënë Zoti dhe të luftojmë kundër një tiranie të përbindshme, që nuk është parë kurrë në katalogun e errët e të dhimbshëm të krimit njerëzor.

Kjo është politika jonë!

Ju do pyesni: Cili është qëllimi ynë? Dhe unë mund t’ju përgjigjem me një fjalë të vetme: është fitorja! Fitore me çdo çmim! Fitore pavarësisht të gjitha tmerreve! Fitore, sado e gjatë dhe e vështirë të jetë rruga, sepse pa fitore nuk ka mbijetesë!

Dhe kjo duhet kuptuar mirë nga të gjithë. Nuk ka mbijetesë të Perandorisë Britanike, nuk ka mbijetesë për gjithçka që Perandoria Britanike ka përfaqësuar, nuk ka mbijetesë as për nxitjen e për shtysën e epokave që e bëjnë njerëzimin të shkojë përpara drejt qëllimit të vet!

Unë e marr përsipër detyrën time me optimizëm dhe shpresë.

4 MUNDËSI STUDIMI

Në akademitë më të mira
të mbrojtjes
në Britaninë e Madhe dhe Itali

Apliko Tani



www.mod.gov.al